




DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 10 / Tetor 2025



Muslimani rrezaton
BESUESHMËRI



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsh.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 09 (508)


Shtator, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

- 04** Myslimani i vërtetë rrezaton besueshmëri
Mehmet Disha

në fokus

- 06** Pluralizmi i Muhamedit (a.s.), atraksion edhe sot
Prof. Dr. Qazim Qazimi

lajme / aktivitete

- 12** 01-Kolegji Universitar “Bedër” hap dyert për vitin e ri akademik 2025-2026
02-Kryetari Spahiu takim me imamët që shërbejnë në institucionet e sigurisë në vend
03-Frytet e besimit ndalen në qytetin e Bulqizës
04-Vizitë pune në myftinitë Sarandë-Delvinë
05-Takim vëllazëror me besimtarët e Sarandës në xhaminë e qytetit bregdetar
06- Kryetari i grupit parlamentar të partisë socialiste, z. Taulant Balla viziton KMSH-në

refleksione

- 14** Esenca e qenieve njerëzore
Raghib el-Isfahani

çështje fetare

- 16** Qasja Islame ndaj kafshëve
Këshilli për Çështjet Fetare – insi.al

familja

- 18** Edukata familjare është një edukim themelor
Nadia Lika

horizonti i besimit

- 20** Deklaratë e përbashkët përsa i përket projektligjit “Për barazinë gjinore” / KNFSH
22 Fetaria në rrjetet sociale, realitet apo syfeaqësi?
Phd. Cand. Ledian Cikalleshi
26 Rëndësia e leximit të Kuranit në jetën e besimtarit
Lauren Luli
28 Jepi lajmin se Allahu e ka falur
Elton Karaj
30 Hudhra, më e forta e më madhështorja ndër antibiotikët / Redaksia

bota shpirtërore

- 34** Çelësat e Qabes dhe ajeti i vetëm i zbritur në të
Tauland Bica

hapësirë femërore

- 36** Koha për mërgim
Hapësire Femërore

këndi i poezisë

- 38** Malli
Fatmir Muja



Muslimani rrezaton **BESUESHMËRI**



Vërtet është bërë si trend tashmë që lajmet në përditshmëri nxjerrin vetëm të këqijat e njerëzve, bëmat e tyre të zymta dhe faqet e fara të çdo portali, a gazete hapen me "të zeza", por kjo ka qenë përherë: një pakicë trazon qetësinë e të gjithëve me një veprim të gabuar, mirëpo ka dhe gjëra të mira e të bukura që ndodhin atje jashtë me shumicë, ka njerëz që promovojnë mirësi dhe rrezatojnë shpresë e besim, njerëz që merren vesh dhe që nuk të gjen e keqja prej dorës a gjuhës së tyre, thjesht nuk i nxjerr kush në lajme.

Profesionalizmi në rolin e gazetarisë e të medias, aq sa është i vështirë të përftohet, po aq është vështirë të ruhet në vazhdimësi. Na duhet të ndërgjegjësojmë gazetarët dhe qasjet e tyre së paku në një raport të balancuar mes kronikave dhe mënyrën se si ato i serviren publikut, sepse nuk është media dhe gazetaria veç për lajme ndodhish ku, për shkak se tërheq sy e bën bujë, lajmi negativ mbizotëron mbi lajmet e tjera pozitive dhe gjërash që ndodhin. Këtu nuk bëhet fjalë për censurë, por për etikë dhe kujdes ndaj përcjelljes së mesazhit në tërësi, bashkë me të vërtetën siç është, pa shtrembëruar qasjen dhe perspektivën për të ndikuar perceptimin e masës.

Këtyre u shtohet edhe pjesa e atyre që shkruajnë mendimet në platformat e rrjeteve sociale të tjera. Këtu gjyqi tashmë bëhet nga masat, nga populli pra, dhe shpeshherë sheh që legjitimohet një vrasës, një vrasje; sulmohen e përbalten institucionet shtetërore por edhe komunitete të ndryshme, e keqja shitet si heroike dhe e mira përgjon strukur gjyqin publik që i bëhet më injorancë teksa e drejta ekzekutohet si në gjyotinë.

Tabloja e mendimeve që del në pah gjatë këtyre ndodhive është vërtet shqetësuese dhe thërret nevojën për t'i rënë "kambanës", ku institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa. I sheh i riu, i sheh i mituri, i shohin të tërë dhe kjo çon në revolta e tjetërsime të brendshme në shoqëri, që vështirë të kurohen lehtë.

Ç'vlerë ka të konstatojë një zymtësi e të bësh tellallin duke i dhënë jehonë ndër njerëz të tjerë, ku brenda nuk ekziston potenciali intelektual dhe shpirtëror për të ruajtur balancat dhe për të ofruar së paku një zgjidhje?!

Të postosh lajme pozitive dhe të ruash balancën e dozës së llojit të informacionit që përçohet te lexuesit, duke mos ngulmuar te lajmet e zeza, nuk do të thotë se po mbulon faktet për të përkrahur instancat. Aspak. Thjesht, njeriu duhet të kërkojë zgjidhje, duke mos i zmadhuar fatkeqësitë, por duke i sheshuar me lutje dhe duke u përpjekur për të ofruar mundësi që njerëzit të mund të ruhen, të ndërgjegjësohen, të kthjellohen. Kjo është qasja fetare ndaj ndodhive: duke i kanalizuar ato gjithmonë nën spektrin e urtësisë dhe kaderit, si dhe duke vënë në përgjegjësi individët kur janë në të gabuar, duke goditur fenomenin e keq nëpërmjet promovimit të shembullit të mirë, duke dhënë gjithmonë alternativën e mirë e të shëndoshë.

Për shembull, në lidhje me zemërimin, i cili është një problem madhor në shoqëritë e sotme, profeti Muhamed a.s. ofronte zgjidhje efektive, duke qartësuar dëmet që zemërimi ka te

njeriu dhe te bota përreth, duke i thirrur ndërgjegjes njerëzore, pastaj u thoshte ndjekësve të tij: "Kur të jeni të zemëruar, uluni, ose shtrihuni derisa t'ju kalojë". Të mos veprosh kur je i zemëruar dhe të durosh e të mbash veten është thelbi i njeriut të qytetëruar dhe pikërisht këtë mirësi e rrezaton besimtari i vërtetë.

Zemërimi është gjendje që thuajse të gjithë e kanë si potencial, por nuk është domosdoshmëri të përdoret, thjesht duhet menaxhuar e mbajtur, derisa të ikë e të tretet. Shejtani e shfrytëzon këtë rast, këtë dobësi njerëzore. Nëse nuk kalon, atëherë ka zgjidhje edhe për këtë: shkon e merr abdest, pastrohesh me ujë, qetëson gjymtyrët duke i larë, kryet duke e fërkuar me dorën e lagur, e më pas fal namaz, del përpara Krijuesit dhe kërkon mbrojtjen e Tij nga mendimet e këqija të vetes e të djajve që shkaktojnë ngatërresa ndër njerëz.

Këtu, profeti Muhamed a.s. bën edhe një dallim madhor duke cituar se: "Nuk është i fuqishëm ai që ka fuqi trupore, i fuqishëm është ai që frenon veten kur zemërohet." Dhe detyra e të gjithëve, por sidomos e besimtarëve që u besojnë fjalëve të të Dërguarit të Zotit a.s., është të bëjnë përherë kujdes duke qenë në vigjilencë, duke mos e lënë zemrën në përhumbe, e përhumbeja të çon në gabime madhore.

Sigurisht praktikat fetare, edukimi fetar, zgjerimi i dimensioneve të njohjes dhe të qenit i lidhur me Zotin për të fituar kënaqësinë e Tij, është misioni kryesor i Islamit që synon te individi. Kjo gjë, pra po të ndodhë që njeriu ta forcojë veten në këtë rrugë, ai bëhet promovues i paqes dhe rrezaton dritë përreth!

Por ndodh që njeriu harron e bën gabime për të cilat nuk pendohet dhe ngadalë merr rrugën e së keqes. Zot ruana! Nevojitet vazhdimisht të qartësojmë veten se duhet të kënaqim Zotin dhe vetëm Atë! Larg Tij, çdo gjë është barrë dhe çdo gjë është lodhje për zemrën.

Bota është krijuar si sprovë dhe duke qenë se është e përkohshme, nuk vlen të lidhësh zemrën me të. Kjo nuk është kaq e lehtë. Praktika është ajo që e forcon bindjen dhe besimi lind pas përpjekjes. Feja jep zgjidhje konkrete në këtë fushë dhe është kjo nga arsyet kryesore përse një pjesë e mirë e të rinjve dhe të njerëzve mbarë sot, çdo ditë e më shumë po ndërgjegjësohen për rëndësinë dhe dobinë domosdoshme të feë në jetët e njerëzve.

Namazi, leximi i Kur'anit, agjërimi, dhënia e zekatit, duatë dhe lutjet, namazi i xhumasë dhe hutbet, duhet që të zgjojnë te njeriu dhe te zemra e tij besimin në Zot dhe mirësitë e moralit dhe frytet e karakterit. Adhurimet bëhen vazhdimisht sepse njeriu është i hapur ndaj rrezikut vazhdimisht. Zot ruana! Të gjithë jemi në botë për t'u sprovuar, ndaj të mos mbahemi me të madh për asgjë, por të jemi falenderues e gjithmonë në lutje, duke kuptuar dobësinë njerëzore dhe duke u strehuar te mëshira dhe udhëzimi i Krijuesit Bujar!

Le të lutemi që Zoti të na mbrojë, të jemi pjesë e shumicës së mirë, shumicës që ndonjëherë mund të jetë kualitative, apo edhe kuantitative... por që është shumicë, qoftë edhe në raport cilësor!

Pluralizmi i Muhamedit (a.s.)

ATRAKSION EDHE SOT

Nuk ka dyshim se respektimi dhe pranimi i feve, etnive dhe kombeve të ndryshme me diversitetet e tyre, është një prej faktorëve të zhvillimit dhe progresit të qytetërimit dhe kulturës në përgjithësi, e asaj Islame në veçanti.

Pasi që, thuajse në të gjithë botën, jotoleranca dhe persekutimi fetar janë duke u paraprirë shumë konflikteve tragjike që përfshijnë probleme etnike, racore dhe të urrejtjes ndaj grupeve të caktuara, mendoj se është mirë t'i kthehemi shembullit më të mirë të ndërtimit të pluralizmit politik dhe multifetar në kohën e Pejgamberit a.s., si shembull atraktiv i tolerances fetare dhe respektimit të diversiteteve.

Për respektimin e vlerave të ndërsjella fetare-kulturore, për bashkëjetesë dhe tolerancë fetare në shoqëritë multi-etnike, kushdo e posaçërisht muslimanët doemos duhet t'i referohen traditës së shenjtë dhe praktikës profetike të Muhamedit a.s. dhe aty do të gjejnë shembëlltynë më të mirë dhe mostrën më të përkryer se si aplikohet dhe jetësohet toleranca fetare-kulturore dhe multi-etniciteti në një bashkësi. Me Hixhretin (migrimin, arritjen) e Pejgamberit a. s. dhe të muslimanëve në Jethrib-(Medinën e sotme) në vitin 622, që atëherë aty në atë qytet-shtet u bënë katër bashkësi etnisch shtet-formuese:

1. Muhaxhirët muslimanë të emigruar nga Meka.
2. Ensarët-vendasit muslimanë, nga fisi Evs dhe Hazrexh.
3. Idhujtarët-vendasit arabë(paganë), nga fisi Evs dhe Hazrexh.
4. Hebrenjtë, të përbërë nga tri fise; Benu Kajnuka, Benu Kurejdha, Benu En-Nedir.

Është për tu theksuar se asosacioni i parë islam, bashkësia islame e themeluar në Medinë, nga besimtarët e ardhur- muhaxhirët nga Mekja dhe muslimanët autoktonë, ensarët nga fisi Evs dhe Hazrexh, nisi rregullimin e marrëdhënieve me hebrenjtë, të krishterët

dhe etnitë e tjera që jetonin në Medinë duke i përcaktuar prioritet për themelimin e institucioneve të shtetit.

Shikuar nga këndvështrimi i besimtarëve monoteistë, ardhja e Muhamedit a.s. në Jethrib (Medinë), ishte një fitore e madhe si për hebrenjtë po edhe për të krishterët, ngase të gjithë këta i përkisnin besimit monoteist. Ka disa ajete të Kur'anit që apelojnë për karakterin dhe praktikën e marrëdhënieve të muslimanëve me ithtarët e librave të tjerë të shpallur "Ehlu'l-Kitabi" si kur edhe në këtë ajet:

"Thoni: "Ne besojmë në Allahun, dhe në atë që na është shpallur (Kur'anin), dhe në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe Esbatëve (pasardhësve të Jakubit), dhe në atë që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe në atë që i është dhënë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallim midis tyre dhe vetëm Atij (Allahut) i përulemi!"

Islami nuk trajtonte hebraizmin dhe krishterimin si fe që kanë qëndrime të tjera, por si fe juridikisht të barabarta dhe fetarisht të shpallura nga Zoti. Statusi i tyre legjitim ishte status fetar e jo socio-politik, kulturologjik, ideologjik apo diç tjetër. Islami nuk e shikonte veten si diçka që vjen në skenën fetare krejtësisht i ri, krejtësisht i pa parë, krejtësisht i pa dëgjuar, por si riafirmim i po asaj të vërtetë që e kanë paraqitur më herët pejgamberët e mëparshëm tek popujt e tyre.

Parë në të kaluarën, po edhe tash, njerëz të ndryshëm fetarë po edhe jofetarë, ndodh të jenë të kërcënuar për shkak se besojnë ose nuk besojnë në diçka. Mundësia për të besuar dhe për ta shfaqur atë besim, njihet dhe mbrohet si liri religjioze-fetare dhe kjo nuk është vetëm çështje morale por edhe ligjore.

Neni 18 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) identifikon liritë si të drejta të të gjithëve, që do të thotë se i mbron fëmijët, të rriturit, vendorët dhe të huajt etj.

1. Kur'ani, sureja "El-Bekare", ajet 136.

Liria për të manifestuar besimin religjioz përfshin mbrojtjen e fjalëve, mësimëve, praktikimeve, kulteve dhe zbatimit të atij besimi. Sipas kësaj ke të drejtë të flasësh për fenë tënde, ta mësosh atë, ta praktikosh vetë ose së bashku me tjerët dhe t'i zbatosh rregullat lidhur me ushqimin, veshjen ose përdorimin e një gjuhe të caktuar, si dhe ritualet e lidhura me besimin e caktuar.

Meqë feja është një ndër komponentet kryesore për të shprehur identitetin kulturor dhe qytetërues të njeriut, është detyrë e të gjithëve ne, të konfirmojnë në vazhdimësi domosdoshmërinë e pranimit dhe të besimit në pluralizëm politik e etnik, fetar e kulturor kudo në botë e posaçërisht në Shqipëri e Kosovë, pa të drejtë cënimi si në aspektin fetar, po ashtu edhe në aspektin e besimit, të kulturave dhe të qytetërimeve të ndryshme. Është detyrim fetar, njerëzor e human për pengimin dhe ndalimin e përdorimit të çfarëdolloj force në zgjedhjen e problemeve ndërfetare, ndëretnike, ndërshtetërore dhe se e tërë kjo mund të bëhet duke u thirrur në një dialog të qytetëruar në vend të përdorimit të çfarëdolloj force. Duhet mbështetur edhe të drejtën për të mbajtur një mendim të kundërt, të drejtës së përgjegjësisë, si dhe të drejtës mbi detyrat dhe obligimet. Muslimanët në vazhdimësi kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë shqetësimin e tyre rreth rrezikut, tjetërsimit dhe të asimilimit që mund t'u ndodhë apo t'u kanoset pakicave etnike dhe fetare në shumë vende të botës. Është detyrim dhe nevojë e kohës që muslimanët në Perëndim si përfaqësues të këtyre pakicave duhet të integrohen në vendet mikëpritëse dhe t'u përmbahen të gjitha ligjeve dhe sistemeve të këtyre shteteve duke mundësuar ruajtjen e identitetit të tyre dhe duke kryer të gjitha obligimet dhe detyrimet e tjera që kanë ndaj shteteve në të cilat jetojnë në mënyrë që të integrohen sa më parë dhe të arrijnë marrjen e të drejtave dhe detyrimeve që ju takojnë.

Është obligim fetar e moral për të gjithë ne, që të gjitha qeveritë dhe udhëheqësit e atyre vendeve ku kanë emigruar myslimanët, t'i falenderojmë dhe t'u shprehim mirënjohje që u kanë mundësuar një jetesë të mirë dhe një liri fetare e mendore të gjitha pakicave që jetojnë në ato vende. Mesazhi profetik i Muhammedit a.s. ishte se:

"Kush nuk i falenderon njerëzit, nuk falenderon as Zotin!"²

Në ditët e sotme, thuajse në të gjithë botën, në shtetet multifetare, ose brenda një shteti, mund të shihen persekutime mbi baza religjioze si ato mes besimtarëve dhe jobesimtarëve, religjioneve tradicionale dhe atyre të "reja-tarikate e sekte të ndryshme", mes një religjioni zyrtar ose të preferuar.

Nuk janë raste të rralla kur sulmet ekstremiste lidhen me fenë, pra kur bërësit theksojnë se e kanë kryer krimin "në emër të Zotit", religjioni dhe liritë e tij përdoren 2. Hadith (thënie profetike) e përkthyer nga Naim Frashëri në kapitullin 'Thelb i Kur'anit'.

dhe keqpërdoren për t'i mbuluar veprimet egoiste ose kërkesat e motivuara politike.

Natyrisht, ashtu si dhe popujt e tjerë, as shqiptarët nuk janë të imunizuar nga radikalizmi dhe ekstremizma të ndryshme; fetare dhe raciste. Por, duhet ditur se këto dukuri të rrezikshme nuk kanë fe, kombësi, as atdhe. Ato bëjnë pjesë në kategorinë e dukurive të sotme globale, transnacionale, "pa pasaportë", ndaj të cilave duhet luftuar bashkërisht, në një front unik dhe në mënyrë të organizuar. Sfidat globale kërkojnë përgjegjësi dhe bashkëpunim global për t'u përballuar me sukses.³

Të gjithë dijetarët islam këto veprime i konsiderojnë si vepra penale dhe të ndaluara fetarisht. Këto veprime konsiderohen se janë përtej fesë së pastër, të mëshirshme dhe të drejtë si dhe në kundërshtim të plotë me mësimet profetike dhe të konsensusit të dijetarëve. Duhet pranuar se ato veprime bartin pas vetes dhe pasoja e dëme të mëdha në shtrembërimin e imazhit të Islamit dhe të myslimanëve, si dhe janë pengesë e madhe në afrimin e njerëzve drejt rrugës së Allahut xh.sh.

Do theksuar se sikundër në Kosovë, po ashtu edhe në Shqipëri, institucionet gjegjëse janë angazhuar seriozisht në luftën kundër terrorizmit, në plan kombëtar dhe ndërkombëtar.⁴ Në të dy vendet është miratuar legjislacioni përkatës që penalizon pjesëmarrjen e shtetasve të tyre në konflikte jashtë vendit, kushdo dhe kudo që të jenë ato. Në të dyja këto shtete, janë arrestuar individë, të dyshuar, se janë marrë me rekrutim të qytetarëve shqiptarë për konfliktin e Lindjes, sikundër që kudo në trojet shqiptare janë arrestuar njerëz për pjesëmarrje në luftra të huaja. Për fat të mirë, askund në trojet shqiptare nuk ka pasur akte terroriste, sikundër kanë ndodhur dhe po ndodhin në vazhdimësi, si në Lindje po ashtu edhe në Perëndim.

Duhet patur në mend se:

"Nuk do të ketë paqe ndërmjet kombeve pa pasur paqe ndërmjet religjioneve. Nuk do të ketë paqe ndërmjet religjioneve pa dialog mes religjioneve. Nuk do të ketë dialog ndërmjet religjioneve, pa e hulumtuar themelimin e religjioneve." (Hans Küng, president i fondacionit për etikë globale).⁵

3. Shkëputur nga artikulli "Xhiahadi rus në Ballkan" Bota Sot | 28.07.2015 00:44 · Dr. Islam LAUKA, diplomat.

4. Parlamenti i Republikës së Kosovës më 12. 03. 2015, miratoi ligjin që për pjesëmarrësit në ato luftëra të burgosen me heqje lirie prej 6-të muaj deri në 15 vjet, dhe për fat të keq, nuk është bërë asgjë për rehabilitimin, integrimin dhe socializmin e tyre në shoqërinë kosovare. "Idividi" - 13.03.2015, Prishtinë, më 12 mars 2015 (MIA) - Parlamenti i Republikës së Kosovës, me 60 vota për, 17 kundër dhe 2 abstenime e miratoi si tërësi Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura...!

5. Hans Küng, president i fondacionit për etikë globale.

01 KOLEGJI UNIVERSITAR “BEDËR” HAP DYERT PËR VITIN E RI AKADEMIK 2025-2026



Kolegji Universitar “Bedër” mirëpriti sot studentët e rinj dhe stafin akademik në ceremoninë e hapjes së vitit të ri akademik 2025–2026.

Në këtë aktivitet morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Rektori i KU “Bedër”, Prof. Dr. Gjergj Sinani, Kryetari i Bordit të Administrimit, z. Surja Shehi, stafi akademik dhe administrativ, si edhe studentët të rinj.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori i “Bedër”, Prof. Dr. Gjergj Sinani, pasi uroi mirëseardhjen të pranishmëve, theksoi rëndësinë e përkushtimit të ndërsjellë për të vijuar traditën e ekselencës akademike. Ai inkurajoi stafin dhe studentët për një tjetër vit të mbushur me arritje, angazhim dhe frymë bashkëpunimi.

Ndërsa Kryetari Spahiu vlerësoi rolin e këtij institucioni në edukimin e brezave të rinj dhe në përhapjen e vlerave të dijes, moralit dhe bashkëjetesës.

Pas përfundimit të ceremonisë së hapjes, Kryetari i KMSH-së, Rektori i KU “Bedër” dhe Kryetari i Bordit të Administrimit zhvilluan një takim me stafin akademik dhe administrativ të këtij institucioni, ku diskutuan mbi objektivat, sfidat dhe prioritetet për vitin e ri akademik.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i uron suksese të gjithë studentëve, stafit akademik dhe administrativ të Kolegjit Universitar “Bedër” në këtë vit të ri akademik!



02 KRYETARI SPAHIU TAKIM ME IMAMËT QË SHËRBEJNË NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË VEND



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me anëtarë të Kryesisë, zhvilloi një takim pune me imamët dhe myftinjtë që ushtrojnë detyrën e tyre në institucionet e sigurisë në vend.

Ky takim kishte për qëllim të trajtonte mbarëvajtjen e aktivitetit, vlerësimin e performancës së shërbimit të deritanishëm si dhe të mbledhte sugjerime për përmirësimin e këtij sektori të rëndësishëm.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu theksoi rëndësinë e kujdesit dhe përkushtimit në përcjelljen e mesazheve të pastra e të drejta të fesë islame, si dhe vlerësoi punën e vazhdueshme të imamëve dhe myftinjve në shërbim të komuniteteve brenda institucioneve të burgjeve. Ai nënvizoi gjithashtu rolin e bashkëpunimit të ngushtë me Drejtorinë e Çështjeve Sociale pranë KMSH-së në realizimin e misionit të tyre.

Më tej, nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, informoi pjesëmarrësit mbi përpjekjet e ndërmarra për përmirësimin e statusit të imamëve që shërbejnë në këto institucione, ndërsa Drejtori i Çështjeve Sociale, z. Edvin Kuçi theksoi rëndësinë e këtij misioni dhe kontributin e çmuar që ofrojnë imamët në këtë fushë.

Nga ana e tyre, imamët dhe myftinjtë pjesëmarrës shtruan për diskutim disa çështje praktike, me synimin për të përmirësuar më tej punën e përbashkët në të ardhmen.



03 FRYTET E BESIMIT NDALEN NË QYTETIN E BULQIZËS



Në xhaminë e qytetit të Bulqizës u zhvillua mbrëmja e radhës fetare si pjesë e ciklit "Frytet e Besimit", e cila mbledhi besimtarët në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore.

Aktiviteti u çel me përshëndetjen e Myftiut të Bulqizës, z. Sejdin Strazimiri, i cili theksoi vlerën dhe freskinë shpirtërore që sjellin mbrëmje të tilla për besimtarët në rrethe.

Më pas, Myftiu i Dibrës, z. Muis Kurtulla, ndau me të pranishmit urtësitë dhe dobisë të duash të sinqertë, duke e cilësuar atë si lidhjen më të fortë mes njeriut dhe Krijuesit.

Në vijim, z. Erjol Haxhiu, Drejtor i Thirrjes dhe Mesazhit Islam në KMSH, foli mbi frytet e besimit në këtë botë, duke theksuar se besimi i sinqertë është burim qetësie, qëndrueshmërie dhe shprese për çdo besimtar.

Ndërsa z. Shpëtim Seranaj, Drejtor i Marrëdhënieve me Besimtarët në KMSH, trajtoi temën e fryteve të besimit në ahiret, duke sjellë mesazhe frymëzuese mbi shpërblimin dhe mëshirën hyjnore për ata që jetojnë me devotshmëri.

Mbrëmja u mbyll në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore, ku të pranishmit patën mundësinë të konsumojnë ujë zemzemi, të sjellë posaçërisht për këtë rast.



04 VIZITË PUNE NË MYFTINITË SARANDË-DELVINË



Seria e takimeve të punës në myftinitë e vendit u ndal këtë herë në qytetin bregdetar të Sarandës, ku Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga drejtues të tjerë të institucionit, u prit nga Myftiu i Sarandës, z. Bledar Mulla, Myftiu i Delvinës, z. Bledar Ali, Administratori i Qarkut, si edhe imamët përkatës të këtyre dy myftinive.

Kjo vizitë pune kishte për qëllim monitorimin dhe mbështetjen në terren të zbatimit të objektivave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme, në kuadër të Planit Strategjik të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për periudhën 2024–2029.

Gjatë takimit, myftinjtë e lartpërmendur prezantuan një përmbledhje të ecurisë së deritanishme të këtyre objektivave, duke evidentuar arritjet edhe sfidat që kërkojnë vëmendje të mëtejshme në vijim.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu përgëzoi myftinjtë dhe imamët për angazhimin e tyre të pandërprerë në përmbushjen e këtyre përgjegjësi, duke i inkurajuar të vijnë bashkëpunimin e ngushtë me strukturat lokale. Ai theksoi rëndësinë e ruajtjes së standardeve të larta në ofrimin e shërbimeve fetare si dhe siguroi mbështetjen e plotë të institucionit për nxitjen e projekteve të reja zhvillimore në këtë fushë.

Më vijim, Nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, trajtoi çështje të ndryshme me karakter kulturor, edukativ dhe social, duke vënë theks të veçantë në organizimin e procesit të regjistrimeve për ritualin e Haxhit 2026. Ai nënvizoi rëndësinë e një promovimi dinjitoz të këtij procesi, si një prej organizimeve më të rëndësishme të institucionit.



05 TAKIM VËLLAZËROR ME BESIMTARËT E SARANDËS NË XHAMINË E QYTETIT BREGDETAR



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një bisedë vëllazërore me besimtarët e qytetit bregdetar të Sarandës. Ky takim u zhvillua ditën e djeshme, pas faljes së namazit të drekës, në Xhaminë e Qytetit, ku morën pjesë dhjetëra besimtarë. Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu u ndal në disa çështje me rëndësi fetare, edukative, sociale dhe kulturore, duke theksuar domosdoshmërinë e forcimit të besimit dhe të vlerave morale në jetën e përditshme. Ai vuri në dukje rolin thelbësor të edukimit të brezave të rinj me frymë islame, si dhe nevojën që çdo besimtar të japë kontributin e tij për përmirësimin e jetës së komunitetit. Gjatë këtij takimi, Kryetari Spahiu shoqërohej nga Myftiu i Sarandës, z. Bledar Mulla.



06 KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË SOCIALISTE, Z. TAULANT BALLA VIZITON KMSH-NË



Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla, zhvilloi sot një vizitë në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë takimit, Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, e uroi z. Balla për detyrën e re dhe e falenderoi për vizitën.

Biseda u fokusua në rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të vijimit të një komunikimi të ngushtë për çështje që shërbejnë në të mirë të komunitetit dhe të vendit.

Takimi ishte i hapur dhe miqësor, ku u diskutuan tematika të ndryshme me interes të përbashkët, që lidhen me zhvillimin shoqëror dhe rolin e institucioneve në forcimin e vlerave të dialogut dhe mirëkuptimit.



ESENCA E QENIEVE *njerëzore*



Esenca (mahijjeh) e çdo gjëje përvetësohet nëpërmjet formës së saj (surah), e cila e dallon atë nga të gjitha gjërat e tjera, siç është forma e një thike, ose e një shpate, ose e një drapëri, e kështu me radhë.

Njeriu përbëhet nga dy pjesë: një trup fizik [material] (beden mahsus) dhe një shpirt i kuptueshëm [jomaterial] (ruh ma'ul). Zoti thotë:

“Vërtet, Unë jam duke krijuar një njeri nga balta. E kur ta kem formësuar atë dhe t'i kem fryrë atij nga Shpirti Im, atëherë përlunë përpara tij në sexhdel!” (Sad, 38:71–72)

Kështu, njeriu ka nga një formë për secilën prej dy pjesëve të tij. Forma e tij fizike materiale: qëndron në qëndrimin e drejtë trupor, thonjtë e gjerë, lëkurën pa qime dhe në të qeshurën e tij. Ndërsa forma e tij shpirtërore e kuptueshme: qëndron në intelektin e tij ('akl), të menduarit (fikr), arsyetimin dhe shqyrtimin (ruwijjeh), dhe të folurit (nutk).

Dijetarët [e logjikës] kanë thënë: “Njeriu është kafshë [racionale] që flet (el-hajawan natik).” Ata nuk kanë

pasur për qëllim me ‘të folurit’ (nutk) vetëm shqiptimin e fjalëve të artikuluar; por me këtë kanë pasur parasysh kuptimet që i përkasin në mënyrë të veçantë njeriut. Ata i kanë përmbledhur të gjitha këto me termin “nutk-të folur.”

E përgjithshmja mund të shprehet nëpërmjet diçkaje të veçantë në të, ose përmes asaj që e bën të nderuar, ose përmes fillimit të saj, si për shembull kur thuhet: Surja Er-Rrahman, ose Surja Jusuf, ose Surja Kurejsh dhe të tjera të ngjashme me to.

Thuhet se njeriu është i dy llojeve: i përgjithshëm dhe i veçantë [i zgjedhur].

I përgjithshmi: përdoret për të përshkruar të gjithë ata që kanë qëndrim të drejtë (trupor), potencial për të menduar dhe potencial për të përfutur nga dituria.

I veçanti: përdoret për të përshkruar ata që e kanë arritur të Vërtetën dhe e kanë besuar atë, dhe që e njohin virtytin dhe e zbatojnë atë sipas mundësive të tyre. Njerëzit dallojnë shumë mes vete në këtë aspekt dhe ndryshojnë ndjeshëm nga njëri-tjetri. Aq sa një

njeri arrin këtë nivel, aq më shumë e meriton të quhet njeri. pra të përfshihet në veprime që janë të posaçme për qenien njerëzore. Kështu që thuhet: filani është më human sesa filani.

Dhe ashtu siç thuhet se njeriu është i dy llojeve, po ashtu ai quhet edhe "kafsha që flet" në dy mënyra:

Në mënyrë të përgjithshme: Këta janë ata që kanë potencialin për të përfituar nga e vërteta dhe e mira. Për shembull, themi: "Njeriu është shkruar," ndryshe nga kali apo gomari. Me fjalë të tjera, ai ka potencialin për të qenë shkruar.

Në mënyrë të veçantë: Këta janë ata që e kanë arritur të Vërtetën dhe e kanë besuar atë, dhe që e njohin virtytin dhe e praktikojnë. Ashtu siç thuhet: Zejdi është shkruar, ndërsa Amri jo. Domethënë, është pikërisht ai që ka njohurinë dhe aftësinë për të shkruar.

Në këtë mënyrë, ai quhet shërbëtor i Zotit (abd'Allah) në dy mënyra:

Në kuptimin e përgjithshëm: do të thotë kafsha (qenia e gjallë) që është e ekspozuar ndaj urdhrave të Zotit, qofshin ato të zbatuara ose jo. Zoti thotë:

"Nuk ka asnjë në qiej dhe në tokë që të mos vijë te i Gjithëmëshirshmi si një shërbëtor." (Merjem, 19:93)

Në kuptimin e veçantë: do të thotë ai që realisht i përmbahet urdhrave të Zotit. Zoti thotë:

"Vërtet, ndaj robërve të Mi ti nuk ke asnjë pushtet." (el-Hixhr, 15:42)

Prandaj, ne e përshkruajmë atë si: i gjallë, dëgjues, shikues, folës dhe racional, dhe të gjitha këto në dy mënyra:

Së pari, ai përshkruhet në mënyrë të përgjithshme: duke iu referuar atyre që kanë jetë shtazore, e cila karakterizohet nga ndjeshmëria, imagjinata, prirjet dhe dëshirat. Ata gjithashtu mund të dëgjojnë tinguj, të perceptojnë ngjyrat dhe të ndihmojnë të tjerët të kuptojnë atë që duan. Ata i kanë të gjitha potencialet që bëjnë të detyrueshme obligimet fetare (tekliif).

Së dyti, ai përshkruhet në mënyrë të veçantë [i zgjedhur]: duke iu referuar atyre që janë të gjallë me jetën që është dituria e synuar (el-ilm el-maksud) në Fjalën e Zotit:

"Që të paralajmërojë këdo që është i gjallë." (JaSin, 36:70)

Ata kanë dëgjim nëpërmjet të cilit i dëgjojnë realitetet e të kuptueshmeve (hakaik el-ma'kulat), dhe kanë shikim të brendshëm (bairah) nëpërmjet të cilit kuptojnë vlerësimet dhe konsideratat (itibarât). Gjithashtu, ata kanë gjuhë me të cilat artikulojnë realitetet e përjetuara dhe të vërtetuara (el-taiât). Këto janë cilësitë që Zoti i ka mohuar për mohuesit injorantë në Fjalën e Tij:

"Të shurdhër, memecë dhe të verbër – ata nuk kuptojnë." (el-Bekare, 2:171)

Në mesin e të gjitha gjallesave të krijuara njeriu është krijuar për të dyja botët. Allahu ka krijuar tre lloje të gjallesave:

Lloji i parë janë ato që janë krijuar vetëm për këtë botë (ed-dar ed-dunja) e që janë kafshët (el-hajawanat).

Lloji i dytë janë ato që janë krijuar për nivele të larta qiellore (ed-dar el-akhirah), pra melaqet (el-melu' el-a'la).

Lloji i tretë është njeriu (el-insan) i cili është krijuar për të dyja botët (ed-darejn).

Njeriu është një urë mes dy shtresave thelbësore të qenies: njëra e ulët – bota e kafshëve; tjetra e lartë – bota e engjëjve. Zoti i Lartmadhëruar, bashkoi në njeriun fuqitë dhe mundësitë e të dy botëve. Ai e bëri të ngjashëm me kafshët: me oreksin trupor, me nevojën për ushqim e pije, me prirjen për shumëzim; me garën e përleshjen, dhe me tipare të tjera shtazore. Por njëkohësisht, e ngjau me engjëjt në dhuntinë e arsyes (aklit), në dritën e ditorisë ('ilmit), në adhurimin ndaj Zotit (el-ibadeh), në pastërtinë e qëllimit (es-sidk), në besnikërinë e palëkundur (el-wefa') dhe në cilësitë e tjera fisnike (el-akhlak esh-sherifeh).

Urtësia që fshihet pas kësaj është se: Zoti, i Lartmadhëruar, e vuri njeriun përpara si të zgjedhurin për ta adhuruar Atë, për të qenë mëkëmbësi i Tij dhe për ta kultivuar tokën që Ai krijoi. Ai e përgatiti atë për praninë e Tij në Xhenet. Kështu, urtësia hyjnore kërkoi që në qenien e tij të mblidheshin së bashku këto dy mundësi – ajo e botës së lartë dhe ajo e botës së ulët – në mënyrë që njeriu të ishte i plotë në misionin dhe përmbushjen e tij.

Sikur njeriu të ishte krijuar si një bishë, i zhveshur nga mendimi racional, ai nuk do të ishte i denjë për khilafetin (mëkëmbësinë hyjnore), as për ta adhuruar Zotin e Lartmadhëruar. Ashtu siç vetë kafshët nuk janë të përshtatshme për këtë, po ashtu ato nuk janë të denja të qëndrojnë në praninë e Tij hyjnore, as të hyjnë në Xhenetin e Tij.

Sikur Zoti ta kishte krijuar njeriun si engjëjt, të zhveshur nga çdo nevojë trupore, atëherë ai nuk do të ishte i përshtatshëm për ta kultivuar tokën e Zotit. Ashtu siç melaqet vetë nuk janë të thirrur për këtë mision, ato edhe pyetën Zotin, e Ai u përgjigj:

"Unë di, me siguri, atë që ju nuk e dini." (el-Bekare, 2:30)

Kështu, urtësia hyjnore kërkoi që të dyja këto mundësi të bashkoheshin në qenien e tij. Duke marrë parasysh këtë urtësi hyjnore, njeriu thirret të kujtojë se ai është njëherësh i kësaj bote dhe i botës tjetër, dhe se nuk është krijuar kot. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"A mos menduat se Ne ju krijuam kot dhe se nuk do të ktheheshit tek Ne?" (el-Mu'minun, 23:115)

Përktheu: Haki Sahitaj

Qasja Islame ndaj kafshëve



Te drejtat e kafshëve

Të nderuar besimtarë e besimtare!

Allahu shprehet kështu në Kuranin Famëlartë:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ مِنْهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا ۝٢٩

“Besimtarëve që kryejnë vepra të mira Allahu u ka premtuar faljen dhe shpërblim të madh.”

(Fet’h, 29)

Sistemi i vlerave që ka sjellë feja jonë e madhe, Islami, në çdo situatë parashikon trajtim me mëshirë dhe dashuri jo vetëm të njerëzve, por të të gjitha krijesave të Allahut. Mëshira është manifestim i emrit të Allahut, Rrahman, dhe kjo ndjenjë e mëshirës që Zoti ynë i Plotfuqishëm na ka dhënë si natyrë është përgjegjësia jonë njerëzore, si ndaj njerëzve, ashtu edhe ndaj krijesave të tjera, në çdo moment të jetës sonë.

Në një hadith Profeti (a.s) ka thënë: اِرْحَمُوا مَنْ فِي الْأَرْضِ

يَرْحَمُكَ مَنْ فِي السَّمَاءِ Tregoni mëshirë ndaj krijesave në tokë, t’ju mëshirojë Kush është në qiell (Ebu Daud, Adab, 58). Ai e donte krijimin për shkak të Krijuesit, nuk poshtëroi e as përçmoi asnjë krijesë të gjallë dhe për kafshët tha: “Sikur të mos ishin kafshët, nuk do të binte shi nga qielli” (Ibn Maxhe, Fiten, 22). Profeti (a.s) i shihte ato krijesa, që nuk kanë mëkat, si mjet mëshirë nga Allahu i Madhëruar.

Transmetohet që një ditë një deve nxiton drejt Profetit (a.s). Ajo ishte duke rënkuar dhe i rridhnin lotë nga sytë. Profeti (a.s) e përkëdheli derisa ajo u qetësua. Pastaj thirri: E kujt është kjo deve? Një djalë i ri prej ensarëve, banorëve të Medinës, u përgjigj: Është e imja. Profeti (a.s) më një shikim të vrenjtur e qortoi: A nuk ke frikë prej Zotit për këtë kafshë që të ka dhënë?! Kafsha ankohet se e ke lënë të uritur dhe e ke lodhur.”

Kështu, sepse Profeti (a.s) ishte mëshirë e gjallë për tërë botët dhe kafshët janë pjesë e tyre.



Pejgamberi ynë (a.s) e paralajmëroi umetin e tij që të mos qëndrojnë mbi kafshë më gjatë se ç'duhet: "Mos përdorni shpinën e kafshëve tuaja si minber. Zoti i vuri në shërbimin tuaj për t'ju çuar në një vend ku vështirë se mund të shkoni vetë." "Plotësoni nevojat tuaja në tokë, jo në shpinën e kafshës suaj në këmbë." (Ebu Daud, 2567)

Kur pa një kllloçkë, që përplaste krahët e saj nga agonia, sepse i kishin larguar zogjtë, i Dërguari i Allahut (a.s.) i paralajmëroi ata që kishin bërë këtë dhe urdhëroi që asaj t'i riktheheshin të vegjëlit. (Ebu Daud, 2675-5268).

Profeti Muhamed (a.s) ndaloi rreptësisht lidhjen e një kafshe të gjallë dhe kthimin e saj në shënjestër për ta goditur (Muslim, 1907; Ebu Daud, 1475). Madje sipas disa transmetimeve, ai i mallkoi ata që e bënin këtë. (Buhari, Dhebaih, 25; Muslim, Sajd, 58-60). Ai nuk lejoi mundjen dhe luftimin mes kafshëve (Ebu Daud, 2562; Tirmidhi, 1708) dhe ndaloi gjuetinë e

tyre thjesht për argëtim.

Ndërkohë që plotësimi i nevojave të kafshëve si ushqimi dhe strehimi çon në faljen e Zotit, lënia e kafshëve të uritura dhe të etura shkakton ndëshkimin e Tij. Prej thënieve të Profetit tonë (a.s) është se një grua e famëkeqe ka fituar faljen e Allahut të Madhëruar, sepse i ka dhënë ujë një qeni të etur në kushte të vështira dhe se një grua që ka burgosur një mace dhe ka shkaktuar ngordhjen e saj, është e destinuar për në ferr.

Kur pa një deve me barkun e saj të mbërthyer nga uria, tha: "Kini frikë Allahun për këto kafshë që s'kanë gojë të flasin" (Ebu Daud, Xhihad, 44)

Ai nuk e toleronte as ofendimin e kafshëve, veçanërisht goditjen e tyre në kokë dhe vulosjen e tyre në fytyrë (Muslim, Libas, 106-112).

Allahu na bëftë njerëz të kujdesshëm dhe të mëshirshëm ndaj krijesave të Tij!

EDUKATA FAMILJARE

ËSHTË NJË EDUKIM THEMELOR



Edukata familjare është një edukim themelor. Kush nuk ka mundur të marrë edukimin e duhur në familjen e tij, e ka të vështirë ta plotësojë me studime a forma të edukimit.

Lind pyetja kush mund ta japë këtë edukim kaq të vlefshëm për jetën e secilit prej nesh?

Përgjigja është: grua, nëna.

Mëshira – mëshira e tyre është një ndjenjë shumë e madhe, që nuk pret fare shpërblim

p.sh. një nënë për të shpëtuar fëmijën e saj, pa shpresuar fare për shpërblim, sakrifikon jetën. Me një sakrificë të vërtet dhe sublime, ajo vetë flijohet dhe bëhet "kurban" për fëmijën e saj. Po të lulëzojë kjo cilësi e tyre ato do të shpëtojnë në të dy

jetët, por pengesat dhe rrymave të ndryshme dhe të këqija nuk e lënë që të lulëzojë kjo cilësi dhe i shtynë ato drejt abuzimeve.

Shembull

Një nënë fisnike, fëmijën e vet i edukon vetëm të shpëtojë nga rreziqet e kësaj jete dhe i merr parasyshtë të gjitha vështirësitë, vetëm e vetëm që ti garantojë fëmijës jetën e përkohëshme. Që ti bëhet djali officer, të gjithë mallin e shpenzon dhe e heq nga medreseja, për ta dërguar në europë. Mjerisht ajo nuk e kupton se e ka hedhur në prehrin e rreziqeve të përjetshme. Ti e di mirë se jeta është e shkurtër punët e vlefshme janë të shumta nëqoftëse ti hulumton në kokën tënde gjënë shumë dituri të padobishme.

Dituria shkencore dhe filozofike që ke në tru duhet ti lërë vendin bindjeve që duke ju lutur Zotit xh.sh. dijet e tua të kthehen dhe të bëhen të dobishme.

A nuk po e kupton se po vihesh kundër mëshirës që ka lindur që më krijimin tënd, po qe se nëna nuk ja jep arsimin e duhur fetar atij duke u kthyer më vonë ky fëmijë në paditës të saj. Për këtë ndërhyrje anormale fëmija do ti kërkojë llogari nënës sepse nuk e ka edukuar që ti përulet ligjeve të krijuesit duke i thënë: 'vetë e ke fajin', sepse nuk më ke forcuar besimin, por më zhyte në këto rreze, ai vazhdimisht do të ankohet ngaqë nuk e ka marrë edukatën e duhur të fesë Islame. Në këtë jetë nuk do ti kushtojë rëndësi mëshirës së nënës dhe ndoshta do të bëjë shumë gabime ndaj sajë.

Nëqofë se nëna nuk e shndërron mëshirën që ka ndaj fëmijës së saj për ta shpëtuar nga rruga e mosbesimit dhe e mëkateve, atëherë nëna bëhet pjesë e të gjitha sevapeve që ka bërë fëmija i saj. Ky fëmijë në botën e ahiretit nuk do të bëhet paditës i saj por me gjithë shpirt do të bëhet një strehues i nënës.

Mësuesi i fëmijës, edukatori më ndikues është nëna e tij, pra nëqoftë se nënat nuk e shpërdorjnë mëshirën me sineritetin që u ka hije, ato nuk duhet të bëjnë abuzime me fëmijët e tyre për t'ua prishur jetën e përjetëshme, se ajo jetë për të është me vlerën e një arke të mbushur plot e përplot me diamante. Duke ia kthyer vëmendjen fëmijës vetëm nga kjo botë e përkohëshme e cila ndaj asaj tjetres është si thërmijë qelqi, atëherë do të ishte një abuzim i mëshirës së saj, që ja ka dhuruar Krijuesi për fëmijën e pamëkatë.

Ankesa për jetën familjare – Ajo, familja është vendmbrojtja për secilin njeri, veçanërisht jeta familjare e myslimanëve është si një lloj parajse e vogël. Nga analizat e bërë përshkak të këtij problem përfundimi ishte; shfrenimi i veseve të rinisë i jep dëm fesë Islame dhe e prish jetën shoqërore të myslimanëve. Femrat e pakujdesshme, lakuriqësia e grave të paturmshme dhe të shfrenuara i godet besimtarët keqazi.

Said Nursi na këshillon: o motrat e mia dhe ju o bijtë e mi mund të ruhen cilësi brilante vetëm atëherë kur të keni marrë edukatën e përshtatëshme të fesë Islame. Një burrë i mençur nuk duhet ti sakrifikojë ndjenjat dhe dëshirat tek gruaja e tij vetëm për kënaqësitë e dhjete viteve të kësaj bote, ta dini se hijeshia më e bukur e grave është në moralin e tyre të brendshëm dhe tek mëshira e tyre e veçantë. Këto cilësi të bukura ata i vazhdojnë deri në përjetësi. Mundohuni ti frenoni dëshirat tuaja, të përcaktoni cilësitë e vyera të grave tuaja të lejuara.

Për besimtarët shoqëria me to nuk është vetëm për një jetë të shkurtër të kësaj bote, por ndoshta edhe për jetën e përjetëshme, ku do të ketë shoqëri përrallore. Tani nën maskën e kulturës dhe qytetërimit të sotëm, pas një dashurie si kafshët, çiftet po ndahen përjetësisht, duke u përballur me një shkatërrim total të jetës familjare.

Është fatbardhë ai burrë që për të mos e humbur bashkëshortin e vet në jetën e përjetshme, e ndjek gruan që është e mirë me punët e Ahiretit, sipas parimeve të fesë islame, duke u bërë në këtë mënyrë edhe vetë një mysliman i mirë. Po

kështu është fatëbarrdhë edhe ajo grua që ka pasur fatin të martohet me një burrë që përjeton fenë Islame dhe përpiqet për të mos e humbur kënaqësinë e jetës së përjetëshme. Ajo duke ndjekur burrin e vet, kthehet në një myslimane të mirë, që Brenda kënaqësive të kësaj jetë, e fiton edhe parajsën e lumtur. Sa fati është ai burrë që imiton gruan e vet në rrugën e mëkateve dhe nuk mundohet fare për ta penguar atë, duke e nxirë jetën akoma më shumë. Po ashtu edhe kjo grua vetë është po aq fatëzezë, që është martuar me një burrë të tillë, që stimulon ligësitë e rrugës së mëkateve, duke i parë këto veprime në një formë tjetër, ajo e kopjon atë. Mjer ato çiftet që sëbashku me njëri tjetrin bashkëpunojnë për të hyrë në thellësinë e zjarrit, duke u shtyrë drejt qytetërimit të shfrenuar.

Lumturia e jetës familjare dhe kënaqësia e kësaj jete dhe e jetës tjetër është kur shfaqen cilësitë e vlefshme të gruas. Kyçi kryesor i jetës familjare është që kur gruaja e sheh burrin e vet duke bërë pabesi, ajo në inat e sipër vepron sjellje të pahijshme. Kështu ndërtesa e kësaj familje shkatërrohet nga themelet. Në këto raste, duhet që gruaja të tregohet e kujdesshme, ta frenojë burrin e vet duke e përmirësuar atë, në mënyrë që ta shpëtojë nga rruga e mëkateve ku ka rënë, që ti garantojë jetën e përjetëshme dhe lumturinë. Po qe se gjërat kërkon ti zgjidhë me inatë dhe demaskon duke bërë të njëjtin gabim, atëherë më shumë se askujt ajo i bën dëm vetes. Dihet se kush e shkel besnikërinë dhe në këtë jetë merr dënimin e merituar.

Gratë heroike me shpirt të madh, në pikpamje të sakrificës dhe mëshirës fisnike, i tejkalojnë burrat e tyre. Krijuesi në qenien e tyre ka vendosur veti dhe aftësi nga ku buron morali i pastër, në jetën familjare mund të zbatojnë moralin e fesë Islame sepse ato janë jo vetëm gjysma e racës njerëzore, por edhe vetë nënat e llojit njerëzorë.

O motrat e mia është shumë më mirë për ju të jeni të kursyera dhe nikoqire të mira ashtu siç jeni krijuar që kur keni lindur. Më mirë të punoni si gratë e fshatit për të nxjerrë bukën e gojës, se sa të hyni nën sundimin e një burri mizor, që e ka bërë si moto të jetës së vet, jetën e paturpshme.

Mos u nënshtroni dhe mos u pajtoni me këto njerëz të rrezikshmëm. Po qe se iu ka rënë fati të jeni martuar me një burrë të pamoralshmëm, që nuk pajtohet me sjelljet e tua të mira, mos u ndani prej tij, por vazhdoni sjelljen tuaj të hijshme me durim. Inshalla këto veti tuajat do ta sjellin bashkëshortin tuaj në rrugë të mbarë. Po të ndaheni do të sorollateni dyerve të gjyqeve, që që nuk pajtohet me moralin islam.

Duhet të bindemi se qejfet dhe kënaqësitë e hallallit janë të mjaftueshëm për njeriun. Në shtëpitë tuaja bisedoni me fëmijën e pamëkatshëm dhe do të jeni njëqind herë më e kënaqur se sa të shikoni një film të pahijshëm.

Në përjetimin e fesë islame dhe në besimin tek rruga dhe ligjet e Allahut do të ndjeni kënaqësi të mëdha shpirtërore, e në rrugën e mosbesimit dhe të mëkatit, edhe në jetën e shkurtër do t'iu shkaktohen hidhërime dhe dhimbje të mëdha.

Kush e mbanë farën e besimit në vetvete, ka garantuar xhenetin edhe në këtë jetë. Kush nuk e ka mbjellë farën në shpirtin e tij, ai ka siguruar rrugën që të shpie në xhehenem që e ndëshkon në të dy jetët me hidhërime të panumërta.

Deklaratë e përbashkët përsa i përket projektligjit “Për barazinë gjinore”

Komunitetet fetare në Shqipëri vlerësojnë rëndësinë e barazisë në përfshirjen sociale dhe në mosdiskriminim, sepse kjo pasqyron barazinë e dinjitetit, që të gjithë njerëzit kanë përpara Zotit.

Nisur nga këto parime dhe bazuar në të drejtat e tij statutores, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i përbërë nga pesë komunitetet fetare (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë), pasi u njoh me projektligjin “Për barazinë gjinore”, mblodhi sot më 23 shtator 2025 Bordin e Presidencës, së bashku me një grup pune të miratuar nga pesë komunitetet fetare, të përbërë nga specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme.

Krerët dhe drejtuesit e të gjitha komuniteteve fetare shprehën shqetësimin e tyre për disa nene dhe përkufizime të projektligjit, të cilat bien në kundërshtim me parimet teologjike dhe traditën e familjes shqiptare. Në veçanti, përkufizimi i termit “gjini”, si koncept gjithëpërfshirës, përdorimi i nocioneve, “identitet gjinor”, “shprehje gjinore”, si dhe të gjitha neneve të tjera të lidhura me to, krijojnë paqartësi ligjore dhe hapësira për keqinterpretim.

Ne, si komunitete fetare, theksojmë rëndësinë e familjes tradicionale të bazuar mbi dy gjinitë biologjike: burrë dhe grua. Për këtë arsye, kërkojmë saktësimin e përkufizimit të termit “Gjini” në projektligj, duke e lidhur qartë me gjininë e përcaktuar në lindje – burrë, grua, vajzë, djalë – në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Komunitetet fetare kanë mbështetur gjithmonë përpjekjet e Shqipërisë për përafrimin e legjisllacionit me direktivat e Bashkimit Evropian. Njohja tradicionale e dy gjinive nuk përbën pengesë për këtë proces – fakt që reflektohet edhe në praktikën e shumicës së shteteve anëtare të BE-së, të cilat vazhdojnë të përdorin një përkufizim binar burrë-grua.

Me dëshirën që këto shqetësime të merren në konsideratë nga institucionet përgjegjëse, riafirmojmë angazhimin tonë për dialog dhe bashkëpunim në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe të sigurt për brezat e rinj, duke u mbështetur në besimin te Zoti dhe respektin për ligjin.

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe të gjithë qytetarët e saj!

Bordi i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë
Haxhi Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë
Fortlumturia e Tij, Joani, Kryepiskop i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë
Imzot Gjergj Meta, Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë
Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjysh Botëror i Kryegjyshatës Bektashiane
Pastor Ergest Biti, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë



Tiranë, 23.09.2025

DEKLARATË PËR SHTYP

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë

Komitetet fetare në Shqipëri vlerësojnë shprehësisht e bazuar në përshirjen sociale dhe në modifikimin, sepse kjo propozim bazuar në dritat, që të gjithë njerëzit kanë përpara Zotit.

Nisur nga këto parime dhe bazuar në të drejtat e tij statutor, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i përbërë nga pesë komitetet fetare (Komiteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryeqyshata Botërore Bektashiane, Vllazëria Ungjillore e Shqipërisë), pasi u njeh me projektligjin "Për bazuarin gjinore", në datën 23 shtator 2025 mbledhë Bordin e Presidencës, së bashku me një grup pune të miratuar nga pesë komitetet fetare, të përbërë nga specialistë dhe ekspertë të fundave të ndryshme.

Konstituti dhe drejtuesit e të gjitha komiteteve fetare shprehën shqetësimin e tyre për disa rreze dhe përkufizime të projektligjit, të cilat bien në kundërshtim me parimet teologjike dhe traditën e famijes shqiptare. Në veçanti, përkufizimi i termi "gjinë", si koncept gjithëpërfshirës, përdorimi i nocioneve, "identitet gjinor", "shprehje gjinore", si dhe të gjitha nënvizet e tjera të lidhura me to, krijojnë paqartësi ligjore dhe hapësira për keqinterpretim.

Në, si komitetet fetare, theksojnë rëndësinë e famijes tradicionale të bazuar në dy gjinitë biologjike: burrë dhe grua. Për këtë arsye, kërkohet ndalimi i përkufizimit të termi "Gjinë" në projektligj, duke e lidhur qartë me gjininë e përcaktuar në lindje - burrë, grua, vajzë, djale - në përputhje me parimet e bazuarit dhe modifikimin.

Komitetet fetare kanë mbështetur gjithmonë përpjekjet e Shqipërisë për përfundimin e legjislatimit me direktivat e Bashkimit Evropian. Ngjajsh traditë dhe dy gjinitë nuk përbën pengesë për këtë proces - fakt që reflektohet edhe në praktikën e shumicës së shteteve anëtare të BE-së, të cilat vazhdojnë të përdorin një përkufizim binar burrë-grua.

Ma dëshirojmë që këto shqetësime të merren në konsideratë nga institucionet përgjegjëse, rrafshojnë sugjerimin tonë për dialog dhe bashkëpunim në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe të sigurt për brezat e ri, duke u mbështetur në besimin në Zotin dhe respektin për ligjin.

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe të gjithë qytetarin e saj!

BORDI I PRESIDENCËS SË KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË



Komiteti Mysliman i Shqipërisë,
Kryetari, Shkëlqesia e Tij H. Bujar Spahiu

Bujar Spahiu

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë,
Furthemoria e Tij Josif, Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

Joan Pelushi
+ Josif

Kisha Katolike e Shqipërisë, President i Konferencës Ipeshkvnore,
Mon. Gjergj Meta

Mon. Gjergj Meta

Kryeqyshata Botërore Bektashiane,
Kryeqysh i H. Dede Edmond Ibrahimaj

Shujit Dede Edmond Ibrahimaj

Vllazëria Ungjillore e Shqipërisë,
Kryetari, Pastor Ergut Bili

Ergut Bili



www.kesh.al

Fetaria në rrjetet sociale, realitet apo syfataqësi?



Teknologjia, e cila po zhvillohet me hapa të shpejtë çdo ditë dhe është pjesë e pandarë e çdo shoqërie, ashtu si po sjell lehtësimin e jetës së njeriut, po bëhet faktor i tjetërsimit dhe i tëhuajizimit të njeriut. Zhvillimi me hapa gjigande dhe të menjëhershme të teknologjisë në dy shekujt e fundit, ka sjellë edhe efekte anësore me të cilat po përballemi si probleme etike, fetare dhe ambientaliste. Për të analizuar dhe hetuar problemet e tilla të teknologjisë, në shekullin e XX, doli një degë e re dhe e pavarur e filozofisë e quajtur Filozofia e Teknologjisë, e cila merret me studimin e teknologjisë ne gjenezë deri te ndikimet shoqërore, kulturore dhe ekonomike të saj.

A është e mire apo e keqe teknologjia?

Para se Filozofia e Teknologjisë të dilte në skenë si degë e pavarur, ne vërejmë kundërshtime që në shekullin e XIX mbi konceptin e përhapur se, nëse teknologjia përdoret për qëllime të mira është e mirë dhe nëse përdoret për qëllime të këqija është e keqe. Mesa duket ky koncept popullor për teknologjinë na shoqëron edhe sot. Por sa i sakte është ky koncept për ndikimin dhe pasojat e teknologjisë?

Filozofi i parë që e ka formuluar si "problemi teknik" ne vitin 1954 është Martin Heidegger, ku thekson se teknologjia, nuk është një mjet pasiv në duart tona, ajo ka logjikën dhe dinamikën e saj të brendshme, prandaj nuk është e mjaftueshme të shohësh teknologjinë si përmbledhjen e aparateve dhe metodave për të arritur një qëllim të caktuar. Ndërsa për hyrjen në sundimin e teknologjisë paralajmëron se është rreziku më i madh që i kanoset njeriut. Sipas tij, nëse e shikojmë teknologjinë si neutrale, atëherë i dorëzohemi asaj në formën më të thjeshtë, sepse ky koncept mjaft i përhapur na verbëron përballë thelbit të teknologjisë. Ajo që duhet bërë, është zotërimi i shpirtit të teknologjisë. Duhet me patjetër mbajtja nën fre dhe sundim ana shpirtërore e teknologjisë.

Sot, teknologjia nuk mund të trajtohet më vetëm më "hallall", apo "haram". Teologët Islamë dhe jo vetëm, nuk e kanë më autoritetin që ta shpallin

të ndaluar përdorimin e teknologjisë për shkak të efekteve negative apo rreziqeve që ajo përcjell. Por edhe zhvillimi i saj me hapa gjigande çdo 5-10 vite e ka bërë shumë të vështirë diagnostikimin e saj për të parandaluar efektet negative. Pikërisht, ky është dhe thelbi i debatit, mbi vlerat e manifestuara me anë të teknologjisë si në media ashtu edhe në rrjetet sociale. Por, duke qenë se të gjithë kanë akses të jenë aktiv nëpërmjet smartphonëve në rrjetet sociale, ne do të trajtojmë disa problematika të hasura ne to.

Rrjetet sociale janë komunitete virtuale që mundësojnë lidhje në kohë reale, sinkronizim të komunikimit, mundësi të postimit dhe ndarjes së fotove, videove, punës origjinale dhe kreative. Ato janë të përdorura prej më shumë se një miliard e gjysëm përdoruesve nga e gjithë bota. Rrjetet sociale janë shumë tërheqëse dhe joshëse për fëmijët dhe adoleshentët, të cilëve ju ofrojnë mundësi të jenë kreativë në internet, të ndajnë idetë dhe të komunikojnë me të tjerët, prej miqve të vjetër deri te të panjohurit. Këto rrjete ofrojnë mundësi për t'u shprehur lirshëm, përfshirë përdorimin e videove, fotove, muzikën dhe chat-in. Më të njohurat janë Tik-Tok, Facebook, X (Twitter), Instagram etj.

Të qenurit fetar në rrjetet sociale, problematikat dhe sfidat

Tashmë është e qartë se përdorimi i teknologjisë dhe rrjeteve sociale ndikon në shumë çështje fetare, madje në shume raste deformat vlerat fetare. Në këtë kontekst, mjaft studiues tërheqin vëmendjen se teknologjia, për të shtuar nevojat e saj shton shpërdorimin (israf). Pavarësisht zhvillimeve pozitive ajo ka arritur në situatën ku dëmton vlerat morale dhe fetare. Duke i shërbyer teknologjisë luftarake bëhet shkakhtar i krimeve kundër njerëzimit dhe ngarkimit me gjynahe. Me ndikimin e teknologjisë njerëzit kanë filluar të bëhen me tamahqarë, të pangopur dhe në vend të shqetësimeve morale-fetare tashmë ka zënë vend të qenurit i suksesshëm dhe egoist. Me konkretisht, ja se si ndikon teknologjia dhe rrjetet sociale

ne jetën fetare te besimtarit dhe çfarë rreziqesh paraqet.

Përdorimi i teknologjisë së telekomunikacionit, solli një problem te madh për popullatën fetare

të të gjitha besimeve. Problemi kryesor i shfaqur në to është transmetimi i pamjeve, filmimeve me përmbajtje zhveshjeje, erotike dhe pornografike. Megjithëse transmetimi i materialeve pornografike është sanksionuar dhe kufizuar për publikun e përgjithshëm, ai që i kërkon mund ti arrijë ato lehtësisht. Ndërsa pamjet, figurat, fotot e njerëzve me përmbajtje zhveshjeje dhe erotike shfaqen lehtësisht sidomos në komunikimet e rrjeteve sociale, të cilat fetarisht konsiderohen si mëkat. Mirëpo kontrollimi për mosshfaqjen, vete-kontrolli për të mos i parë apo evituar është problem i pazgjidhur, i cili vazhdon të jete shkak gjynahesh me të cilin përballen besimtarët. Dëmi fenomeneve të lartpërmendura është i qarte për këdo, mirëpo vetë përdorimi i teknologjisë sjell probleme të tjera si humbja e kohës, angazhimi me gjëra të padobishme, varesia ndaj teknologjisë, humbja e vëmendjes, zbrazëtia e ndjenjave fetare dhe syfaqësia, të cilat nuk hyjnë direkt në pjesën e ndalesës (haramit) dhe të ketë një reaksion të menjëhershëm ndaj tyre. Ndërsa për çështjen e kontakteve dhe komunikimeve të dy gjinive me njëri-tjetrin, pa qenë në rrethin e "mahremit", çështjet e tradhtisë, divorcit dhe problematikave sociale që ajo sjell, është debat që kërkon shkrim më vete, prandaj nuk do ta trajtojmë këtu.

Rrjetet sociale të përhapura në shoqëri, janë në marrëdhënie me të

gjithë përbërësit e kulturës së

asaj shoqërie. Feja, e cila ka rol kryesor në aspektin shoqëror, nuk mund të jete e pavarur nga

përdoruesit në rrjetet sociale. Çdo individ me ndjeshmëri fetare i cili shfaq bindjet e tij nëpër rrjetet sociale, të përkufizuara si kulture popullore (popular culture), ka përgatitur terrenin e një fetarizmi popullor. Individët të cilët e formojnë fetarizmin e tyre nëpër rrjetet sociale, dashje pa dashje, edhe perceptimet fetare i formojnë sipas retorikës së rrjeteve sociale. Është e qarte se forma reale e jetës fetare, me atë të rrjeteve sociale nuk pritet të jete e njëjta. Jeta shoqërore e transformuar nga rrjetet sociale, ka ndikuar dhe transformuar edhe jetën e fetareve. Elementët e jetës moderne, të cilat gjejnë vend në rrjetet sociale, kanë transformuar jetën dhe komunikim fetar. Detyrimet fetare të cilat njerëzit nuk i kanë praktikuar dot në jetën reale, apo edhe ato që i veprojnë, me vazhdimin e retorikës dhe shfaqjes në rrjetet sociale, ndjehen mirë shpirtërisht në këtë hapësirë publike. Në shumicën e rasteve kur i veprojnë, këta sillen si fetare konservatore.

Të qënurit fetar është një fenomen i cili përfshin dimensionet e besimit të njeriut, jetën fetare

me baze adhurimet, sipas urdhërësive dhe ndalesave, dijet, eksperiencat, ndjenjat, ndikimet dhe

organizimet fetare. Jeta fetare dhe fetarizmi ndryshojnë sipas kushteve që rrethojnë çdo shoqëri.

Për shembull, një individ i cili rregullisht i kryen adhurimet, në një shoqëri mund të konsiderohet ai më fetar, ndërsa diku tjetër konsiderohet

ai i qe i respekton rregullat morale. Ne jetën moderne dimensionet e te qenurit fetar janë me te gjera, te ndryshme dhe kane fituar llojshmëri. Situatat e ndryshme si ekonomia, fetare, veshja fetare, retorika fetare, festat, kapitali fetar, imazhet fetare dhe rrjetet sociale i kane ndryshuar dimensionet te qenurit fetar. Bashke te gjitha këto kane sjellë një pikëpamje tjetër në botëkuptimin shoqëror te fetarizmit.

Fetarizmi i rrjeteve sociale, i shndërruar ne fetarizmin e botes post-moderne, pa vërejtur nëse

njeriu i jeton vete qëndrimet apo sjelljet te vendosura ne dimensionin e besimit, përpiket ti shpalle dhe vendosi në subkoshiençën shoqërore të rrjeteve sociale që ai është fetar. Fetarizmi në rrjetet sociale përbëhet me tepër nga fetarizmi komercial dhe sipërfaqësor. Kur njerëzit komercializojnë një retorikë fetare në rrjetet sociale, sa më tepër të marri pëlqime ose të shpërndahet, aq më tepër përcakton të qenurin fetar. Ky është shndërrimi fetarizmit në shou dhe populizëm. Duke qenë se feja në rrjetet sociale është me e moderuar dhe me e hapur ndaj kritikave edhe mundësia për tu përhapur është me e madhe. Por, fetarizmi i rrjeteve sociale mbetet mbi slogane.

Botëkuptimi i kulturës popullore në botën moderne është bërë shkak i transformimit të të

kuptuarit të fesë. Shndërrimi i fesë ne kulture popullore ka shkaktuar daljen e fetarizmit popullor ose te fetarizmit te medias sociale. Mekanizmat e rrjeteve sociale kane rrëmbyer funksionin socializues te institucioneve fetare duke e ndryshuar dhe shndërruar.

Individualizimi dhe pluralizmi fetar me rrjetet sociale është zhvendosur ne nivele me te larta. Situata ku prodhohet dhe konsumohet çdo dite e shenjata ne rrjetet sociale, e kane larguar fenë nga funksioni i saj socializues duke e reduktuar ne botëkuptimin individual. Fetarizmi i reduktuar ne atë individual mbetet vetëm si shfaqje.

Fetarizmi i shfaqur, më tepër se fetarizmi operativ dhe shpirtëror, trajtohet si fetarizëm me shtysë të jashtme dhe për qëllime të jashtme. Në fetarizmin e shfaqur, feja nuk është elementi i parë përcaktues i sjelljeve te një individi fetar, por një mjet për qëllime te tjera. Ata qe janë te lidhur nga jashtë e marrin fenë si një mjet dhe e kthejnë ne funksion te qëllimeve te tyre. Ky lloj fetarizmi është larg sinqeritetit dhe një veprim i plote syfaqësie për njerëzit, gjë e cila fetarisht nuk është e pranuar. Kështu pra, fetarizmi ne rrjetet sociale here pas here duke u shndërruar ne dimensionin e shfaqjes dhe shou arrin ne dimensione te tjera.

Mirëpo here pas here, feja apo të qenurit fetar në rrjetet sociale, është e barasvlershme me atë të

jetës reale. Rrjetet sociale krijojnë një ambient te pakufizuar për komunikim. Nga elementët pozitivë dhe mund të përmendim se në këtë ambient njëkohësisht mund të përshëndetësh me "selam" qindra njerëz, të ndash gëzimet, ke mundësi të informohesh për njerëzit në nevojë dhe ti ndihmosh ata, të marrësh apo të shpërndash dije dhe moral të mirë. Në të njëjtën kohë rrjetet sociale në botën moderne, kanë një funksion te rëndësishëm ne përhapjen e botëkuptimit, konceptit dhe aktiviteteve fetare.

Rëndësia e leximit të Kuranit në jetën e besimtarit



Më i miri ndër ju...

Kur'ani është drita hyjnore me të cilën u ndriçua njerëzimi që para shumë shekujsh. Është manuali më i saktë që e orienton njeriun kah e mira dhe që shpjegon çdo gjë të fshehtë e të dukshme. Kur'ani u bë dritë ndriçuese jo vetëm në kohën e tij më të artë, por ai vazhdon edhe sot të jetë margaritari më i çmuar për zemrat e pastra dhe të singerta që rrezatojnë në mënyrën më të rregullt dhe të qartë bukurinë e Islamit.

Allahu zbriti si mesazh të parë "Ikra" pra "Lexo", që përbën ndriçimin e mendjes së njeriut. Kur'ani zbriti si dritë ndriçuese për shpellën Hira mbi malin e Dritës, si orientues dhe gurë kilometrik në rrugën e dritës, i dërguar njeriut më të ndritur, u transformua në pishtar ndriçues për të gjithë kohërat dhe për gjithë njerëzimin. Kjo sepse zemrat që u ndriçuan me të, u bënë më të buta, mendjet mbi të cilat rrezatoi ai u bënë më të afta dhe njerëzit që u zbukuruan me dritën e Tij, u ngritën në horizontet më të larta qiellore.

Kur'ani, përveçse një manual orientues për njerëzimin,

është kreu i dijes së shëndoshë dhe i mendimit të shëndoshë; gjithashtu është baza e shprehjes së drejtë dhe e deklaratës logjike. Bashkëbiseduesi i tij i parë është Vula e Profetësisë, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), kurse ai vetë, diferencuesi i shquar i të vërtetës nga gënjeshtra, është mbreti i të gjithë librave qiellorë e joqiellorë.

Po, Kur'ani ka parashtruar një këndvështrim të veçantë me një stil jashtëzakonisht të qëlluar për të vërtetën e gjithësisë, materies dhe njeriut, një këndvështrim me të cilin ai i trajton si një të tërë ekzistencën dhe njeriun brenda ekzistencës dhe e vendos çdo gjë në vendin e vet pa nënvlerësuar dhe lënë mënjane asnjë pikë madje.

Në periudhën e parë kur Kur'ani e nderoi faqen e tokës me ardhjen e tij, ushtroi një ndikim aq të papërfytyrueshëm si në shpirtin, ashtu dhe në mendje e zemra, sa që përsosmëria e brezave të rizguar në jetë nën atmosferën e tij prej drite është një mrekulli në përmasa që s'lenë nevojë për mrekulli të tjera mbi të dhe, gjithashtu, është e pamundur të gjenden të ngjashmit e

atyre njerëzve përse u përket besimit, fesë, horizontit të mendimit, moralit, si dhe njohjes dhe ndjerjes prej tyre të enigmës së pozitës së robit ndaj Allahut dhe adhurimit ndaj Tij! Ç'është e vërteta, në atë periudhë, Kur'ani përgatiti një brez të tillë me emrin "sahabe". Prandaj dhe ne e quajmë sot brezi i të ndriturve.

Nuk është një befasi që ai brez të arrinte horizonte të tilla shpirtërore, sepse përkushtimi që ata kishin në leximin e Kur'anit dhe të pasurit në krye Mësuesin e Mësuesve, të Dërguarin e Allahut e bënte shumë më të lehtë çështjen. Atëherë kjo na e bën më të lehtë të arrijmë në një konkluzion se, nëse duam të jemi prej njerëzve të klasifikuar si të mirë, duhet t'i përkushtohemi kësaj rruge që i ka dhënë provat e saj që para qindra vitesh dhe sot vazhdon të jetë po aq e suksesshme sa në kohërat e para.

Përkushtimi i ndaj Kur'anit është një prej veprave më të rëndësishme dhe më të pëlqyera nga Allahu i Lartësuar. Ajo është lavdëruar në shumë ajete kuranore si dhe nga Profeti a.s. në hadithet e tij plot urtësi. Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar për të lexuar Kur'anin, të meditojmë dhe të punojmë sipas porosive të tij. Atyre që e lexojnë Kur'anin ashtu siç duhet lexuar, u ka premtuar një shpërblim të madh, kur thotë: "Ata të cilët e lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe dhurojnë në fshehtësi dhe haptazi nga ajo që i kemi furnizuar, ata kërkojnë një tregti që nuk shteron. Kështu që Allahu t'i shpërblejë për atë ç'kanë vepruar dhe t'u shtojë nga mirësia e Tij. Ai është Falës dhe Falenderues"¹. Ndërsa i Dërguari i Allahut në një hadith të transmetuar nga Osman bin Affani r.a. thotë kështu: "Më i miri prej jush është ai i cili e mëson Kur'anin me të gjitha hollësitë e tij dhe pastaj ua mëson të tjerëve"².

Pa dyshim se njeriu i cili lexon, kupton dhe mediton mbi Kur'anin përvetëson mësimet e sakta me të cilat ai orientohet kah punëve të mira dhe kështu transformohet në një individ që vepron vetëm të mirën. Ai bëhet njeriu i besueshëm dhe i zgjedhur në shoqëri, aq sa gjen një pëlqim dhe pranim nga çdo person me të cilin takohet. Kjo është edhe zanafilla e rregullimit të të gjitha problemeve të shoqërisë. Pra, individ i shëndoshë sjell automatikisht dhe shoqërinë pa probleme. Profeti e tregon kështu gjendjen e besimtarit që i përkushtohet leximit të Kur'anit dhe atij që e neglizhon: "Shembulli i besimtarit që lexon Kur'an është si shembulli i qitros, era dhe shija e saj është e mirë. Ndërsa shembulli i besimtarit që nuk lexon Kur'an, është si shembulli i hurmës arabe, ajo nuk ka aromë, por shija e saj është e ëmbël..."³

Për shkak të epokës ku jetojmë dhe falë zhvillimit të vrullshëm teknologjik, mendja e njeriut pothuajse është e fokusuar e gjitha mbi materialen. E fokusuar në fitime, në shit-blerje, interesa, veshje, ndërtime dhe ka shumë

njerëz që kanë arritur në atë pikë që, edhe pse falen dhe agjërojnë, mundohen të gjejnë një lidhje interesash me adhurimet. Ndërsa një besimtar i mirë, largpamës, duhet të mësojë t'i bëjë balancën këtyre dy gjërave dhe duke qenë se 23 orë nga 24 orëshi ynë është pothuajse larg marrëdhënies sonë me të Vërtetin, duhet patjetër të shfrytëzojmë rastet që na paraqet Allahu xh.sh. për të rforcuar lidhjet me Të, për t'u Dashuruar edhe një herë me Madhështinë e Tij, Cilësitë e Tij.

Një nga këto mundësi që do të flasim sot, janë edhe 3 muajt e mirë që po na afrohen, Rexheb, Shaban e Ramazan. Njeriu e ka gjithmonë nevojën e një pikënisjeje ose një shtyese. Kështu që, tre muajt janë shumë domethënës për këtë psikologji të njeriut. Krahas shtimit të adhurimit dhe veprave të mira gjatë këtyre muajve, është një rast i mirë për të filluar një jetë të re me Kur'anin. Na bën përshtypje jeta e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe jeta e njerëzve të tij më të afërt, sahabet e nderuar (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Ata ishin shumë larg aktualitetit tonë. Edhe pse në netët e tyre nuk mungonte namazi i tehexhudit, nuk mungonin agjërimet nafle, nuk mungonin namazet e falura gjatë, nuk mungonin asnjëherë leximet e Kur'anit ditë e natë, hatmet të cilat përfundonin në 2-3 ditë, kur vinte puna te muajt e mirë, i konsideronin sikur po vinte ramazani. Pothuajse Ramazani i tyre ishte 3 muaj. Në të dy sahihët përcillet nga Ibn Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) të ketë thënë: "I Dërguari i Zotit a.s. ishte njeriu më bujar. Bujaria e tij arrinte kulmin gjatë ramazanit, kur takohej me Xhibrillin dhe e përsërisnin së bashku Kur'anin. Xhibrili e takonte atë për çdo natë të ramazanit dhe i lexonte Kur'an. Kur takohej me Xhibrillin ishte më zemërgjerë në mirësi se një erë e lehtë (të cilën e sjell Allahu si lajmëtare të shiut)"⁴.

Në një hadith tjetër Profeti a.s. thotë kështu: "Tri kategori njerëzish Allahu i dashuron: Ai që zgjohej natën dhe lexon librin e Allahut. Ai që kur jep me dorën e djathtë nuk e kupton as dora e majtë. Ai që, në kohë lufte, edhe pse shokët e tij janë të shpërndarë duke u larguar nga aty, ai qëndron, nuk kthehet dhe lufton i vetëm me armikun"⁵.

Sigurisht që kur themi "lexim Kur'ani" nuk e kemi fjalën për një lexim sipërfaqësor, por të thelluar, të menduar, po aq sa të qartë, të saktë, të kuptueshëm e të bukur nga ana jonë. Stina e këtyre tre muajve është më e mira për t'u fokusuar në leximin e Kur'anit.

Atëherë le t'i përkushtohemi Kur'anit, ndërkohë që po trokasim ne derën e këtyre ditëve të shënuara për ne dhe ta forcojmë akoma më tepër lidhjen, përkushtimin dhe shoqërinë me të. Sepse kjo do të ishte mënyra për t'u bërë më i miri ndër besimtarë dhe më i dashuri për Allahun xh.sh.

1. Fatir, 29-30.

2. Buhari, Fedailu'l-Kuran, 21.

3. Muslim, Salatu'l-Musafirin, 243.

4. Buhariu, 6; Muslimi, 2308.

5. Ebu Daudi, Xhihad, 36; Tirmidhiu, Xhennet, 25.

JEPI LAJMIN SE ALLAHU E KA FALUR

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا لِيُطَاعَ بِإِذْنِ اللَّهِ وَلَوْ أَنَّهُمْ إِذْ ظَلَمُوا
أَنْفُسَهُمْ جَاءُوكَ فَاسْتَغْفَرُوا اللَّهَ وَاسْتَغْفَرَ لَهُمُ الرَّسُولُ لَوَجَدُوا اللَّهَ
تَوَّابًا رَحِيمًا

“Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre. Dhe në qoftë se ata, kurdo që ta ngarkonin veten (me gjynahe), të vinin te ti për t’i kërkuar falje Allahut dhe i Dërguari t’i lutej Allahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se Allahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Nisa, 4/64)

Në tefsirin e ajetit 64 të sures en-Nisá mufesiri i madh Ibn Kethîr shkruan si më poshtë.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre.”** (Nisa, 4/64) Pra, kujtdo që i ka dërguar profet, Allahu ia ka bërë atyre detyrim, që t’i binden atij. (...)

Allahu i Madhëruar vijon kështu: “Dhe nëse ata, kurdo që ta ngarkonin veten (me gjynahe), të vinin te ti për t’i kërkuar falje Allahut dhe i Dërguari t’i lutej Allahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se Allahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Nisa, 4/64) Në këtë formë Ai i udhëzon në rrugë të drejtë të revoltuarit dhe mëkatarët. U dikton atyre rrugën, që kur prej tyre ndodh një gabim apo mosbindje, duhet të shkojnë tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.), t’i luten Allahut për falje në prezencën e tij (a.s.) dhe t’i kërkojnë të Dërguarit të Allahut (s.a.s) që të lutet për faljen e tyre. Nëse e bëjnë këtë, atëherë Allahu i Madhëruar do ta pranojë pendimin e tyre, do të tregojë mëshirë dhe do t’i falë. Prandaj Allahu i Gjithëmëshirshëm në vijim ka thënë: “Me siguri do ta gjenin Allahun Pranues të pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Nisa, 4/64)

Një grup dijetarësh, mes tyre edhe Shejh Ebû



Nasr b. es-Sabbâg, autor i veprës “esh-Shâmil”, përcjellin prej el-Utbij (ose Utbâ) një tregim të njohur. el-Utbij rrëfen kështu (një përtim të vetin):

Po qëndroja pranë varrit të Pejgamberit (s.a.s.). Erdhi një beduin dhe tha: «Selam mbi ty, o i Dërguari i Allahut! Dëgjova fjalën e Allahut të Madhëruar: “E kur ata i bënë dëm vetvetes, sikur të kishin ardhur tek ti e të kërkonin falje nga Allahu, dhe i dërguari të kërkonte falje për ta, me siguri do ta gjenin Allahun Pranues të pendimit dhe Mëshirues.” Ja pra, unë kam ardhur tek Ti, duke i kërkuar falje Allahut për mëkatet e mia dhe duke kërkuar nga Ti, që të bëhesh ndërmjetësues (të bësh shefaat) tek Zoti për mua.»

Pastaj shprehu këtë poezi:

“O më i miri, eshtrat e të cilit i janë varrosur, prej

aromës së tyre u stolis sipërfaqja dhe nëntoka.

Shpirti im u flijoftë për varrin ku Ti banon, aty gjendet pastërtia, bujaria dhe fisnikëria.”

el-Utbij vijon: Pastaj beduini u largua dhe mua më zuri gjumi. Në ëndërr e pashë të Dërguarin e Allahut (s.a.), i cili më tha:

«O Utbij, shko dhe jepi lajmin e mirë beduinit, se Allahu e ka falur.» (Ibn Kethir, II/306)

Imam en-Neueuí e ka përmendur këtë tregim ndër veprat e mira që mund të bëjë vizitori i Profetit Muhamed (a.s.), duke u lutur pranë varrit të Tij të bekuar (s.a.s.) për shefaat. Neueuí shpreh se dijetarë të mëdhenj si el-Máuerdí, el-Kádí Ebú et-Tajjib dhe të tjerë prej shafive e kanë vlerësuar këtë sjellje dhe e kanë transmetuar si diçka e vlefshme. (el-Mexhmú, VIII/274).

Hudhra, më e forta e më madhështorja ndër antibiotikët



Allahu i Lartësuar thotë: "Kujtoni kur i thatë: O Musa! Ne nuk mund të durojmë vetëm një lloj ushqimi, prandaj lutju për ne Zotit tënd të na dhurojë nga ato që jep toka; perime, tranguj, thjerrëza, qepë dhe hudhra." (Bekare, 61)

Në kohë të lashta në gjuhën arabe është përdorur fjala "Fum", më pas f-ja është shndërruar në "th" e kështu njihet në gjuhën arabe të sotme nga të gjithë.

I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) ka thënë: "Hani hudhrën e njomë, se sikur meleku (Xhibrili) të mos më vinte, do ta kisha ngrënë".

Të dërguarit të Allahut i dhurohet një ushqim në të cilin kishte hudhra, ai ia dha atë Ebu Ejub el-Ensarit ndërsa ky i fundit i thotë: O i dërguari i Allahut, e urren për vete dhe ma jep mua? I Dërguari i ndershëm i thotë: "Unë takohem me atë që nuk takohesh ti".

I dërguari i Allahut i ka njohur dobitë mjekësore të hudhrës dhe i ka ftuar shokët e tij dhe myslimanët që ta konsumojnë atë të njomë, por, duke patur parasysh erën e shpifur në rrugët e frymëmarrjes, nuk e ka konsumuar, sepse meleku i ka ardhur dhe i ka komunikuar shpalljen dhe ka qenë në gatishmëri të këtyre takimeve. Për këtë thotë për hudhrën e qepën në një thënie tjetër: "Kush ka ngrënë hudhër apo qepë të largohet prej nesh ose të qëndrojë në shtëpinë e tij". "Kush i ha ato të dyja, t'i përdorë të gatuarat." Kjo sqaron synimin e Profetit (a.s.) në mbrojtje të ndjenjave të të tjerëve nga era e hudhrës sepse disa njerëz e urrejnë e shqetësohen prej saj; por me këtë nuk shihet ndonjë kontradiktë ndërmjet urdhrit për të ngrënë hudhër dhe shmangies së atij që e përdor atë, sepse është detyrë e çdo myslimani që të respektojë ndjenjat e të tjerëve. E çuditshme! Po cili është sekreti që i dërguari i Allahut na ka urdhëruar që të konsumojmë hudhrën? Për këtë do të mundohemi që të japim njëfarë përgjigjeje në mënyrë që të njihemi me dobitë mjekësore në thënien e Profetit (a.s.) i cili nuk flet në ajër.

Faraonët dhe kremi i rahbanëve (priftërinjve)

Disa dijetarë kanë bindjen se dorëshkrimet të cilat këshillojnë konsumin e hudhrave janë dorëshkrime babilonase. Por ka një të vërtetë historike që Faraonët e kanë përdorur hudhrën si ushqim e ilaç për më shumë se 2900 vjet p.e.r. dhe kanë nxjerrë prej saj vaj që e quanin "Vaji i Priftërinjve ose i fallxhorëve", i cili ka patur një nam të madh në shërimin e sëmundjeve të ndryshme. Gjithashtu e kanë përdorur në formën e një peri ku kanë radhitur në të thelpinj e hudhrës e ia vendosnin në qafë fëmijëve që

kishin parazitë.

Historiani grek Herodoti përmend se punëtorët e Faraonit gjatë ndërtimit të piramidave kanë konsumuar sasi të mëdha hudhre e qepe që arrin në 1600 tilanë (peshë faraonike e vjetër) dhe se këto dy lëndë janë shkak i forcës që i bëri këta punëtorë të ngrenë këto ndërtesa gjigante e madhështore të mbështetur vetëm në forcën trupore.

Gjithashtu hudhra është përmendur në Berdijatë Mjekësore Faraonike e veçanërisht ne Berdijen Kahun e Kalsijraxh me veçoritë e tyre shëruese në formën e kremit që vendoset për shmangien e dhimbjeve të kyçeve, inflamacionet e lëkurës, kundra pickimit të insekteve, një përbërje e hudhrës me prasin etj.

Ebu Bekër er-Razi ka thënë: Hudhra shpërbën erërat, fryrjen e barkut, i dobishëm për atë që në stomakun e tij ka amalgamim viskoz, vlen për të moshuarit, kurse për ata të cilët vuajnë nga kolona hudhra është e dobishme nëse shoqërohet me gjethet e ullirit të butë e të freskët.

Ibn Sina thotë: Hudhra e përzier me mjaltë është e dobishme në sëmundjet e Vitiligo, kruarjes, njollat e trupit e zgjeben qelbësuese. Nëse hudhra përzihet me temjan vlen për dhimbjet e dhëmbëve. Nëse përzihet me mjaltë e pihet nxjerr ballgamin e dy parazitët.

Ibn Bejtar thotë: Hudhra është kundra helmeve, është e nxehtë, e lehtë, e butë, vlen për sëmundjen e qerosës, qetëson dhimbjen e dhëmbëve, të gjoksit, cermës e dhimbjes së kyçeve.

Daud el-Antaki ka thënë: Hudhra vlen për ftohjen dhe astmën, vështirësinë në frymëmarrje, ulcerat në stomak, erërat e këqija, kolonën, shpretkën, verdhëzën, kyçet, shiatikun, shton rrjedhjen e menstruacioneve, shpërbën tumoret e gurët në veshka, ndërpret ballgamin, parandalon sklerozën, paralizën dhe dridhjet.

Analiza shkencore dhe vetitë mjekësore

Hudhra dhe murtaja

Historia na tregon se në qytetin e Marsejës kur kaploi sëmundja e murtajës në vitin 1776 e shfarosi dhjetëra mijëra banorë, qeveria e asaj kohe kap katër hajdutë gjatë vjedhjes së tyre të disa njësive tregtare të këtij qyteti pa patur frikë se do të sëmureshin nga kjo sëmundje. I dënuan ato me vdekje duke i premtuar heqjen e këtij dënimi nëse tregojnë sekretin e mosinfektimit të tyre nga murtaja. Kur e treguan sekretin, hajdutët thanë se ato

kanë konsumuar një ilaç magjik të përbërë nga hudhra dhe uthulla, e që u bë shkak në shfaqjen e rekomandimit të uthullës sterilizuese me hudhër kundra plagëve dhe ulcerave të qelbëzuara.

Hudhra përmban rreth 25 për qind vaj avullues me ngjyrë të verdhë e erë të fortë e që nuk ka ndikim nga drita me përbërje sulfur, 49 për qind proteinë, 2 për qind yndyrë, 22 për qind karbohidrate, 48 për qind kripëra, 60 për qind ujë, disa lëndë pasterizuese, vitamina të ngjashme me hormonet seksuale dhe fshihen tiparet shëruese të hudhrës pas sasive të pasura me sulfur, fosfor, kalcium e lëndë të tjera që përmendëm më lart e që kanë dobi mjekësore e veçanërisht ndikojnë në zhdukjen e shumë mikrobeve e për këtë konsiderohet si pastrues i shkëlqyer, sterilizues e dezinfektues.

Gjithashtu është vërtetuar se po ta shtypim me dhëmbë hudhrën për një periudhë prej 3 minutash është e mjaftueshme për të mbytur të gjitha mikrobet e gojës.

Hudhra, antibiotiku më madhështor

Hudhra konsiderohet si penicilina e streptomocina e të ngjashme me të. Studimet e kërkimit shkencore vërtetojnë se hudhra ka ndikim të mirë kundra mikrobeve që shkaktojnë qelbëzim të plagëve dhe mikrobeve nga të cilat përhapen shumë sëmundje helmuese e infektive. Hudhra shërben për pastrimin e dezinfektimin e gojës, ndihmon në shërimin e bronkitit të fortë e të përkohshëm, ftohjes, astmës etj. Në spitalet e Rusisë kanë përdorur avuj me hudhër për shërimin e plagëve.

Eksperimentet laboratorike tregojnë se po të grijmë me dhëmbë hudhrën nga 1-3 minuta është e mjaftueshme për të mbytur mikrobet e difterisë që gjenden tek bajamet, influencës e në rastet e dizenterisë.

Nëse hudhra hahet ose merret erë me hundë shkon në gjak dhe trupi i njeriut e ruan ndikimin e tij kundra mikrobeve e viruseve për disa orë me radhë. Shkencëtarët rusë arritën të nxjerrin një lëndë nga hudhra për ta përdorur atë si antibiotik të cilën e quajtën me emrin Penicilina Ruse.

Hudhra për presionin e gjakut, arteriosklerozën e diabetin

Eksperimentet mjekësore kanë vërtetuar se hudhra lehtëson shumë presionin e gjakut

arterial dhe shton aktivitetin e qarkullimit të gjakut. Një eksperiment laboratorik tek disa lepuj të cilët merrnin ushqim të pasur me kolesterol, kur i kanë shtuar vajin e hudhës në ushqim studiuesit panë që lënda e kolesterolit nuk kaloi në gjak apo në muret e enëve të gjakut, ndërsa kur e aplikuan një gjë të tillë tek njeriu vunë re se po t'i hedhim pak vaj hudhre gjellës të çonte në të njëjtin rezultat, dhe me këtë konsiderohet ilaç i vërtetë për rastet e arteriosklerozës, gjithashtu është nga mbrojtësit më të mirë kundra diabetit e rritjes së tensionit të gjakut. Eksperimente të kryera nga ekspertë të ndryshëm të botës na tregojnë gjithashtu se hudhra i shkrin kristalet që formohen në trupin e njeriut dhe pakëson presionin e gjakut në arterie.

Për shërimin e tifos, meningjitit e kancerit

Mjekët mundësuan shërimin e meningjitit me anë të hudhrës. Dihet se shërimi i vetëm i kësaj sëmundjeje vrasëse është ilaçi kimik, i cili lë efekte anësore të rrezikshme e për më tepër që kërkon një trajtim të gjatë e të kushtueshëm. Gjithashtu hudhrën e kanë përdorur në shërimin e tumoreve kanceroze teksa rezultatet e kërkimeve të shkencëtarëve francezë kanë vërtetuar se konsumi i rregullt i hudhrës parandalon zhvillimin e qelizave kanceroze. Organizata Botërore të Shëndetësisë nëpërmjet studimeve të saj ka vërtetuar se banorët e Kinës janë njerëzit më pak të prekur me raste të kancereve si rezultat i konsumit të rregullt të hudhës në të gjitha ushqimet e tyre.

Hudhra për neuropleksusin, aparatin tretës e zemrën

Studiuesit vërtetojnë se hudhra ka ndikim qetësues për neuropleksuset që gjenden në shtresën poshtë perdes së mbyllur të stomakut e të zorrëve dhe se konsumimi i hudhrës së njomë pastron stomakun e zorrët, ndihmon në sekretimin e acidit të stomakut që shërben për tretjen e ushqimit. Hudhra shmang rastet e kolitit, kapsllëkun e shkuarjen e barkut. Eksperimentet e kryera nga hulumtues francezë kanë vërtetuar se ekstrakti i hudhrës është ilaç rezultativ për tifon, dizenterinë, ndërsa studimet kineze thonë se hudhra shëron sëmundjet e zorrëve

bakterioze e parazitare e veçanërisht ajo e shkaktuar nga bakteri salmonelë. Sipas tyre, nëse njeriu konsumon 25 thelpinj hudhër të ziera në një gotë ujë e që ta konsumojë në mëngjes esëll për tre ditë me radhë eviton dy parazitët e barkut e veçanërisht parazitin shirit, shëron fryrjet e barkut, shkuarjen e tij, ndërsa mjekët e sotëm sigurojnë se avujt e ngritur të hudhrës kanë të njëjtin ndikim me lëngun në vrasjen e mikrobit të difterisë e dizenterisë thjesht duke i marrë avujt për rreth 5 minuta pas konsumimit të dozës së hudhrës.

Vlen të theksohet se shumica e shkencëtarëve të farmakobisë sigurojnë se nga llojet më të mira të ilaçeve veçanërisht për sëmundjet e zemrës janë ato që në përbërjen e tyre kanë hudhër si element bazë për rastet e astmës, papastërtive të gojës, dhëmbëve e aparatit urinar.

Është bërë e qartë se hudhra ka dobishëruese të mëdha në rastet e heqjeve të barkut të rënda apo të përkohshme të influencës dhe se konsumimi i hudhrës me grirjen e dhëmbëve vepron për pastrimin e plotë të mikrobeve të dëmshme.

Gjithashtu është bërë e qartë se konsumimi i hudhrës pastron rrugët urinare si dhe eviton krijimin e gurëve në veshka, fshikëz apo kanalet urinare.

Ndërsa për rastet e pickimit të insekteve kafshimit të qenit apo pickimit të gjarpërinjve, konsumimi i hudhrës është i dobishëm pavarësisht nëse merret nga goja apo në formë kremi, sepse ajo ka ndikim shumë të madh kundra helmeve.

Përdorimi i brendshëm

Për rastet e dizenterisë, dobësimi të mëlçisë, rrufës, influencës, përdoren hudhra të qëruara dhe se doza e përshtatshme është një thelb tre herë në ditë gjysmë ore para buke.

Për rritjen e presionit të gjakut, meningjitit e diabetit, i sëmuri konsumon dy thelpinj hudhër esëll në mëngjes.

Për heqje barku të fortë, përdorim përzierjen e përbërë nga (100 gr. hudhër të qëruara + 300 gr. ujë + 100 gr. sheqer) mesatarisht tre lugë gjelle ç'do ditë para buke.

Për të përzënë parazitin e vetëm (shiritin), përdoret përzierja e përbërë nga një kaptinë hudhër e madhe pasi të qërohen i shtohet një

gotë e gjysmë ujë e zihet për 20 minuta. Këtë përzierje i sëmuri e konsumon në mëngjes esëll pa ngrënë gjë por mund të përdorë lëngje e pije deri në drekë. Ky proces përsëritet çdo ditë deri sa të dalë shiriti.

Për të larguar dy parazitët në stomak e zorrë. Përdoret zierja e 25 thelpinj hudhër në ujë ose qumësht, ose përzihet hudhra e qëruar me dy pjesë sheqer. Ndërsa për sa i përket fëmijëve të vegjël, mjafton të pinë një gotë qumësht të zier me disa thelpinj hudhër në të (në raportet tre thelpinj hudhër dhe tre të katërtat ujë ose qumësht) duke kujtuar që përdorimi i tij bëhet i ngrohtë.

Përdorimi i jashtëm

Për shërimin e ftohjes përdorim hudhrën e grirë me masazh në zonën e shpinës e në dy krahët e shtyllës kurrizore.

Gingivat e ulcerat e gojës e dhimbjes së dhëmbëve përdoret hudhra e grirë me masazh ose vendoset në vendin e dhimbjes.

Për shmangien e zbokthit të kokës përdorim 4 thelpinj hudhër të grirë të përzier me një sasi të përshtatshme alkooli të pastër ku përzierja vendoset në një shishe qelqi të mbyllur e lihet në një vend të thatë për 10 ditë e më pas kullohet e mesazhohet koka me të dy herë në ditë në mëngjes e në darkë.

Për pastrimin e zhdukjen e ulcerës e plagëve të qelbëzuara, përdoret 10 gr. lëng hudhre + 90 gr. ujë + 2 gr. alkool duke i lyer ose vendosur me një garzë në vendet e lënduara.

Për rastet e zgjebes, përdoret mesazhi me përzierjen e përbërë nga hudhra e grirë me vaj një herë në ditë duke e shoqëruar me banje me ujë të nxehtë e domosdoshmërisht duke u veshur.

Për rastet e inflamacioneve të lëkurës e pickimit të insekteve, përdoret lëngu i hudhrës dhe pras në vendin e dhur duke e vendosur me napë.

Për zhdukjen e kallove përdoret një thelb hudhër i grirë në vendin e dëmtuar duke e lidhur me një napë gjatë gjithë natës e duke e hequr në mëngjes, një gjë e tillë përsëritet derisa të zhduket kalloja.

Çelësat e Qabes dhe ajeti i vetëm i zbritur në të



Qabja e ndërtuar nga Ibrahim (a.s.) kishte dy dyer. Njëra për të hyrë dhe tjetra për të dalë nga Qabja. Që të dyja dyert ishin në nivel me tokën dhe nuk kishte pengesa të tjera. Këto dyer nuk kishin çelës. Çdo kush mund të hynte dhe dilte lirshëm sa herë të dëshironte. Edhe pse ka transmetime se derën e parë e ka vendosur mbreti i Jemenit, Ebu Kerib Esad el-Himjeri, kjo nuk është e sigurt. Në vitin 605, kur fisi Kurejsh restauroi Qaben, derën hyrëse e ngritën 2.13 metra nga toka dhe i vendosën kyç. Ndërsa derën dalëse e mbyllën me mur. Lartësia e derës është 2.22 ndërsa gjerësia 1.90 metra.

Dera e Qabes dhe dera e vogël e quajtur "dera e pendesës" që të nxjerr në çati, për herë të fundit janë bërë nga mbreti Melik Abdulaziz me flori të pastër. Në derën kryesore është përdorur 280 kg. flori.

Dera është bërë prej druri dhe e veshur me kornizë floriri. Ndërsa mbi derë janë shkruar emrat e bukur të Allahut. Ndërtimi i të dyja dyerve zgjati 1 vit dhe u vendosën në vend në vitin 1363 të hixhretit. Ndërsa dera e sotme është bërë nga Halidi, djali i mbretit Melik Abdulaziz.

Çelësi i derës së Qabes

Një ndër punët e caktuara në lidhje me haxhin ishte edhe detyra e "hixhabes". Hixhabe do të thotë të kujdesesh për Qaben, të mbash çelësin dhe ta hapësh atë në kohë të caktuara për besimtarët. Këtu përfshihet edhe kujdesi ndaj vendit të Ibrahimit (a.s.), kujdesi ndaj sendeve me vlerë të saj dhe mbajtja pastër apo ndërrimi i mbulesës së Qabes.

Detyra e hixhabes mbahej nga Kusaj bin Kilab i

fisit Huza. Pjesë të kësaj përgjegjësie ai bëri edhe Rifade (kujdesi për haxhilerët) dhe Sikaje (shërbimi me ujë zemzemi për haxhilerët).¹

Pas Kusajit këtë detyrë e mori djali i tij Abdud-dar. Dhe më pas kjo detyrë kaloi nga babai tek i biri. Në kohën kur u çlirua Mekka çelësin e Qabes e kishte Osman bin Talha djali i Talha bin Abdullah.

I dërguari i Allahut kërkon çelësin e Qabes

I dërguari i Allahut, ditën e çlirimit të Mekës, erdhi në Qabe mbi devenë e tij. Bashkë me të ishte edhe Usame bin Zejd. Përhëndeti gurin e zi me shkopin e tij dhe filloi të bënte tavaf. Nga njëra anë bënte tavafin nga ana tjetër me shkopin e tij rrëzoi 370 statuja idhujsh që ishin përreth Qabes, duke lexuar ajetin "Erdhi e vërteta (hak) dhe u zhduk e kota (batil). Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur."²

Pasi mbaroi tavafin erdhi te dera e Qabes dhe zbriti nga deveja. Ndërkohë që sahabet pastronin mbeturinat e copëtuara të statujave dhe e lanin atë me ujë zemzemi.³ Në këtë mënyrë Qabeja u pastrua edhe shpirtërisht edhe fizikisht. Tashmë radhën e kishin statujat brenda saj.

I dërguari i Allahut thërriti Osman bin Talhan dhe i kërkoj të sjellë çelësin. Osmani vrapoi drejt shtëpisë por nëna e tij nuk donte t'ia jepte çelësin. Ai menjëherë vendosi dorën në shpatë dhe tha: "Nënë, ose më jep çelësin ose kjo shpatë del nga vendi i saj". Pasi kuptoi se situata ishte serioze nëna ia dha çelësin dhe ai ia dërgoi Resulullahut (a.s.).⁴

I dërguari i Allahut (a.s.) mori çelësat dhe hapi derën e Qabes. Ndërkohë që Kurejshët u habitën nga kjo, sepse ata besonin se askush tjetër përveç atij i cili kishte detyrën e hixhabes nuk mund ta hapte derën e Qabes.⁵ Në këtë mënyrë u thye edhe një tabu. Ashtu si thyeshin statujat rreth Qabes në çdo hap që ai hidhte po ashtu me çdo fjalë dhe veprë që bënte thyeshin tabu të shumta nga mendjet e njerëzve. Resulullahu (a.s.) kur hyri brenda mori edhe Osman bin Talhan, Usame bin Zejdin dhe Bilalin (r.a.) dhe më pas e mbylli derën.⁶

I dërguari i Allahut brenda Qabes

Pasi hyri brenda shkoi në çdo cep të mureve bëri tekbiere dhe falënderoi Allahun. Në muret e brendshme të Qabes ishin vizatuar figura që sipas tyre ishin Ibrahim, Ismaili dhe Is'haku (a.s.), ku në duart e Ibrahimit (a.s.) qëndronin shigjeta falli. Pasi e pa këtë, Resulullahu (a.s.) tha: "Allahu i mallkoftë! Ibrahim kurrë nuk ka hedhur fall." dhe më pas

urdhëroi t'i fshinin të gjitha. Pas kësaj Ai e pastroi Qaben nga brenda, fali dy rekate namaz dhe iu lut Zotit. Ai qëndroi rreth një orë brenda saj.

Para se të hapte derën për të dalë jashtë, Xhamia e Shenjtë ishte mbushur me Kurejshët e Mekës të cilët prisnin vendimin që do merrte Resulullahu (a.s.) për ata. Pas pak Profeti i mëshirës e filloi fjalën, duke theksuar se i vetmi Zot që meriton të adhurohet është vetëm Allahu dhe më pas vazhdoi me këto fjalë: "S'ka Zot tjetër përveç Allahut. Ai është një dhe nuk ka të ngjashëm. Ai e solli premtimin në vend. Ai e ndihmoi robin e Tij dhe mposhti i vetëm të gjitha ushtritë armike. O njerëz! Çfarë vendimi mendoni se do të marr për ju?" Mekasit e trishtuar me një zë thanë: "Ne mendojmë se ti do të marrësh një vendim të hajrit për ne, sepse ti je profet fisnik. Një vëlla fisnik dhe djallë i një vëllai fisnik. Fuqia tashmë të përket ty."

Pas përgjigjes së tyre Profeti i mëshirës tha:

"Ju them ato çka vëllai im Jusuf i tha vëllezërve të tij: 'nuk ka mëri për ju sot, Allahu ju faltë! Pa dyshim Ai është falësi më i madh.' Shkoni tani, jeni të gjithë të lirë. Por kini kujdes! Nga sot është ndaluar çdo lloj fajdeje dhe kamate. Çdo hasmëri gjaku dhe pasurie tashmë është poshtë këmbëve të mia. Nga tradita e xhahilijes do të lejohet vetëm Hixhabe (kujdesi për Qaben dhe mbajtja e çelësit) dhe Sikaje (kujdesi për haxhilerët dhe qerasja me ujë zemzemi)."⁷

Kush do të mbajë çelësin e Qabes

I Dërguari i Zotit (a.s.) ndërkohë që po zbriste shkallët e Qabes lexonte këtë ajet: "Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni."⁸ Ky ajet sapo i kishte zbritur ndërkohë që ishte brenda në Qabe. Ajeti tregonte qartë se ku do të shkonte amaneti prandaj dhe Resulullahu (a.s.) edhe pse xhaxhai i tij Abasi dhe djali i xhaxhait tjetër Aliu i kërkuan që detyra e hixhabes t'i jepej atyre, ai pyeti se ku është Osman bin Talha. Pasi Osmani erdhi, ai (a.s.) e lexoi përsëri ajetin e sapo zbritur brenda Qabes dhe i tha: "O Osman! Ky çelës është e drejta jote. Sot është dita për të treguar mirësi dhe mirënjohje. Urdhëro, merre atë çka Allahu ju ka dhënë. O bijtë e Ebu Talhasë, merreni këtë amanet të mbetur nga gjyshërit tuaj dhe trashëgojeni deri në pafundësi. Tani e tutje këtë çelës nga ju mund të tentojnë ta marrin vetëm zullumqarët."⁹ Që nga ajo ditë, sot dhe deri në ditën e Kiametit çelësi i Qabes mbahet nga fisi i Ebu Talhasë (r.a.).

1. Mahmud Shakir, et-Tarihu'l-Islami, I/92

2. Isra', 17/81.

3. Es-Salihi, Subulu's-Selam, V/238.

4. Muslim, Hac 83.

5. El-Hattab er-Ruajni, Meuahibu'l-Xhelil, IV/511.

6. Buhari, Haxh 51-52.

7. Es-Salihi esh-Shami, Subulu'l-Huda ue'rr-Rreshad, V/242

8. Nisa', 4/58.

9. Ibn Sa'd, Tabakat, V/13

Koha për mërgim

Jobesimtarët e Mekës filluan ta mundonin më shumë Profetin tonë të dashur pas vdekjes së xhaxhait të tij. Kudo që e shihnin e ofendonin dhe e përçmonin. Me këdo që të fliste mbreti i profetëve, ata shkonin e i thoshin: "Mos e dëgjoni se ç'thotë ai. Ai është një i çmendur. Ne e kemi larguar atë prej vetes ngase është gënjeshtar".

Në krye të torturuesve vinin Ebu Xhehli me xhaxhain e vërtetë të Profetit tonë të dashur, Ebu Lehebin. As gruaja e Ebu Lehebit, Umu Xhemilja nuk ngelej pas në këtë drejtim. Ajo mendohej që të vendoste gjemba në rrugën nëpër të cilën kalonte Profeti, si e si për t'i shkaktuar atij dhimbje e për t'i përgjakur këmbët.

Sikur të mos mjaftoheshin me kaq, jobesimtarët u munduan që ta vrisnin Profetin e nderuar, paqja qoftë mbi të. Megjithëse e provuan shumë herë, Allahu i Madh e mbrojt Profetin e Tij prej tyre. Këto tortura nuk ushtroheshin vetëm ndaj Profetit Muhamed, ato i bëheshin edhe besimtarëve të tjerë. Kur padrejtësia arriti kulmin, Allahu u dha leje myslimanëve që të mërgonin.

Një pjesë e myslimanëve kishte emigruar në Etiopi, ndërsa tani vendi që do të shkonin ishte Medina. Në Medinë kishte mjaft njerëz që i kishin besuar Profetit tonë të dashur. Ngaqë i dinin shumë mirë vuajtjet që po hiqte, ata i thanë: "O i Dërguar i Allahut, sikur të vije pranë nesh, në Medinë. Ne jemi të gatshëm të të ruajmë prej çdo rreziku. Jemi të nderuar ta flijojmë jetën për Ty." Ata e kishin bërë disa herë këtë lloj kërkesë.

Prandaj Profeti Muhamed a.s. i urdhëroi myslimanët që ndodheshin në Mekë të drejtoheshin për në Medinë. Pas tyre do të ikte edhe ai vetë. Myslmanët u ndanë gjatë natës në grupe dyshe dhe treshe për të udhëtuar drejt Medinës. Në fund, në Mekë mbetën vetëm Profeti Muhamed a.s., Aliu, si edhe shoku i tij më besnik, Ebu Bekri.

Ky zhvillim i fundit i tërboi fare mohuesit. Menjëherë ata

organizuan një mbledhje mes tyre. Filluan të flisnin se ç'duhet të bënin. Zërat e tyre dëgjoheshin edhe jashtë. Njëri prej tyre u shpreh:

- Tani besimtarët e rinj mund të mbledhin një sërë mbrojtësish në Medinë. Asnjë prej tyre nuk duhet të mbërrijë atje, përndryshe do ta kemi punën pisk në të ardhmen.

- Ti vërtet thua ashtu, por tashmë ata kanë mbërritur në Medinë. Këtu kanë mbetur vetëm Muhamedi me shokun e tij Ebu Bekrin, - foli një tjetër.

- Atëherë duhet të pengojmë vajtjen e këtyre të dyve në Medinë.

- Ç'do të bëjmë me ta, ta zëmë se i pengojmë? - pyeti një tjetër.

- I fusim në burg. Le të rrinë të mbyllur derisa të vdesin.

Teksa biseda vazhdonte me mendime të ndryshme, fjalën e mori Ebu Xhehli:

- Po ku e lënë në burg atë shokët e tij?! Ata vijnë edhe për të luftuar, vetëm që ta shpëtojnë. Unë kam një mendim më të mirë.

- Cili është ai? - pyetën të gjithë me një zë duke parë nga Ebu Xhehli.

- Ta vrasim Muhamedin. Nëse vdes ai, shokët e tij do të përçahen, pasi do të ngelen pa një kokë që t'i drejtojnë.

Ky mendim u pëlqeu të gjithëve. Ebu Xhehli shpjegoi edhe mënyrën se si do ta vrisnin. Në krye të grupit të vrasjes do të ishte ai vetë.

Allahu i Madh ia bëri të ditur të Dërguarit të Tij ato çfarë ishin folur në atë mbledhje. Profeti ynë vendosi që të nisej për në Medinë. E thirri Aliun për t'i treguar vendin e amaneteve që po i linte. I kërkoi atij që t'ia dorëzonte të gjithëve në kohë. Ç'gjendje e habitshme! Mekasit këtë merrnin vendimin për ta vrarë Profetin, ndërsa në anën tjetër ia çonin atij sendet e tyre me vlerë që t'ua ruante, sepse e dinin që ai ishte më



i besueshmi. Aliu do të flinte në shtratin e të dërguarit të Allahut. Më në fund ra nata.

Çeta e mosbesimtarëve, me në krye Ebu Xhehlin, kishte rrethuar shtëpinë e Profetit tonë të nderuar. Ishin rreth dyzet vetë. Dyzet luftëtarë të pazemër. Sipas planit të tyre, ata do t'i sulleshin Profetit përsipër, sapo të dilte prej shtëpisë. Më pas, do t'i jepnin fund jetës së tij me hanxharët që mbanin në duar.

Profeti a.s. doli prej shtëpisë, mori një grusht dhë dhe pasi lexoi një pjesë prej sures Jasin ia hodhi mosbesimtarëve grushtin e dheut që kishte në dorë, duke ecur mes përmes këtyre krijesave që në fytyra u shfaqeshin të gjitha prapësitë që kishin bërë deri në atë çast. Me lejen e Allahut, asnjë prej tyre nuk e pa të dërguarin teksa kalonte.

Në rrugë Profetit Muhamed i doli përpara një burrë. Ai donte që t'i lajmëronte mekasit se njeriun që ata po prisnin e kishte parë me sytë e tij. Ai iu afrua shtëpisë së Profetit. Me të vërtetë që ishin një tufë e madhe njerëzish që ia kishin rrethuar shtëpinë. Iu drejtua Ebu Xhehli, që gjendej në krye:

- Habitem me ju. Prisni të dalë dikush që nuk gjendet në shtëpi, - i tha.

Ebu Xhehli u nxi në fytyrë. Me zërin e tij të ashpër e pyeti tjetrin:

- Ç'kërkoni të thuash ti more kopuk?

- Ju jeni duke pritur për Muhamedin, por më kot, sepse unë, pa ardhur këtu, e pashë atë në rrugë. Ai më tha edhe se ju ishit këtu duke e pritur për ta vlarë.

- Gënjën. S'ka mundësi të ketë dalë, kur ne jemi kaq njerëz që po bëjmë roje. Do ta kishim parë me patjetër po të kishte dalë.

- Ai ka shkuar me kohë atje ku do të shkonte. Ju ka hedhur dheun syve kur është larguar. Pa shihni njëherë si jeni tërë pluhur në rroba.

Për një moment, të gjithë zunë të shihnin njëri-tjetrin. Vërtet,

të gjithë ishin të pluhurosur. Allahu i madh e kishte shpëtuar Profetin e Tij duke bërë një mrekulli. Megjithatë mohuesit nuk donin ta besonin. Menjëherë thyen derën dhe hynë brenda në shtëpi.

- Ja shtrati! Edhe Muhamedi që është shtrirë brenda tij. Sulm! - thirri Ebu Xhehli.

Shkuan në anë të krevatit dhe ngritën mbulesën. Kur u matën të godisnin me hanxharë, Ebu Xhehli bërtiti:

- Prisni! Ky është Aliu.

Më pas e pyeti:

- Ku është Muhamedi?

Aliu iu përgjigj:

- Nuk e di. Është atje ku dëshiron të jetë.

Jobsimtarët u shpërndanë menjëherë për t'u mbledhur sërisht në Qabe. Vendosën që ta gjenin medoemos Profetin. Do ta pengonin që të largohej në drejtim të Medinës. Prandaj u nisën menjëherë për në shtëpinë e Ebu Bekrit. Atje gjetën vajzën e tij, Esmanë.

- Ku është babai yt bashkë me shokun e tij? - e pyetën.

- Nuk janë këtu, - iu përgjigj ajo.

- Atëherë ku kanë shkuar?

- Nuk e di se ku kanë shkuar, por edhe po ta di, nuk jua them.

Kjo përgjigje i ktheu idhujtarët në të çmendur. E rrahën vajzën dhe hynë me dhunë për të kontrolluar shtëpinë. Pasi nuk lanë cep pa kontrolluar, shkuan përsëri drejt Qabes. Në fund të mbledhjes ata erdhën të gjithë në një mendim. Vendimin e tyre e përhapën në të gjithë Mekën me anë të kasnecëve:

- Atij që do të sjellë Muhamedin së bashku me shokun e tij Ebu Bekrin, do t'i jepen plot njëqind deve si shpërblim. Mos thoni pastaj që nuk dëgjuam. Atij që i sjell të dy, gjallë a vdekur, do t'i jepen njëqind deve dhe shumë dhurata të tjera.

Malli

Kur malli më mori për veten e gjithë ekzistenca qau
Trupi im një peme të pagjelbëruar i ngjau
Një degë me fruta plotë jetë sëpata nga trangu e ndau
Një vjeshtë e papritur erdhi, gjethet i këputi e i thau

Po rrënjët e mia nuk vdiqën edhe pse fati i vrau
Dikush që shumë më lavdëronte, më shumë nga të gjithë më shau

Shpirti vetëqortues edhe një herë pyeti veten
Ç't'u desh ta vrisje zemrën kur brenda saj kishe gjithë jetën?
Ç't'u desh që lotët e tu të pastër t'i ndyesh?!

Kur thyen zemrën tënde çdo gjë që jeton brenda saj do ta thyesh
Por ta thyesh një zemër nuk është më keq se sa ta kthesh atë në gur
Të kesh një vend në zemrën e dikujt do të thotë të
mos mbetesh në vetmi kurrë

Shëndeti është brenda teje e sëmudja nga jashtë troket
Sëmundjen mund ta njohësh, shëndeti mbetet sekret

Aty ku gjuhët heshtin, dhimbja me njëmijë gjuhë flet
Unë jam këtu sërish me heshtje, me fjalë e me germa

Unë jam këtu sërish se s'më ka vdekur zemra
Unë jam këtu sërish si lule me nektarin e falur

Nëse je si bleta, këtu ke për t'u ndalur
Asgjë s'është e imja, e tëra është dhuratë
Në mungesë të thumbit, s'do kishte as mjaltë.





Elham Abdullah b. Mahmud
el-Mevsilij el-Hanefij

EL-IHTIJARU
LI TA'LILI-L-MUHTARI

اختيار لعيل المختار

Elham Abdullah b. Mahmud
el-Mevsilij el-Hanefij

EL-IHTIJARU
LI TA'LILI-L-MUHTARI

اختيار لعيل المختار

Elham Abdullah b. Mahmud
el-Mevsilij el-Hanefij

EL-IHTIJARU
LI TA'LILI-L-MUHTARI

اختيار لعيل المختار

Elham Abdullah b. Mahmud
el-Mevsilij el-Hanefij

EL-IHTIJARU
LI TA'LILI-L-MUHTARI

اختيار لعيل المختار

Elham Abdullah b. Mahmud el-Mevsilij el-Hanefij

EL-IHTIJARU
LI TA'LILI-L-MUHTARI

اختيار لعيل المختار

Tiranë - Prishtinë - Shkup, 2025